



RAPORT

I

KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VEPRIMTARINË E ZHVILLUAR

GJATË VITIT 2010

Shkurt, 2011

I.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	4
II.	RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR	5
	2.1. LICENCIMI DHE ECURIA E OPERATORËVE TË LICENCUAR	5
	2.2. SANKSIONET NDAJ SUBJEKTEVE	10
	2.3. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË KKRT-së.....	10
	2.4. ÇËSHTJET GJYQËSORE.....	11
	2.5. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË TRANSMETIMIT	12
III.	PROGRAMACIONI	15
	3.1. SITUATA PROGRAMORE NË MEDIAN ELEKTRONIKE	15
	3.1.1. Ligjshmëria dhe struktura programore.....	15
	3.1.2. Dukuri të përmbajtjes dhe etikës së programeve.....	17
	3.1.3. Programet për fëmijë, ligji dhe deontologjia	19
	3.1.4. Programet në Radiotelevizionin Publik	21
	3.2. PROGRAMET INFORMATIVE	22
	3.2.1. Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha e plotë.....	22
	3.2.2. Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha sinkron	23
	3.2.3. Raportet kohore për aktorët “sinkron”	24
	3.2.4. Raportet kohore për gjininë	25
	3.2.5. Raportet kohore për temën e lajmit.....	26
	3.2.6. Dukuri të monitorimit të edicioneve informative.....	27
	3.3. MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE LIGJORE PËR TRANSMETIMIN E REKLAMAVE	28
	3.4. STUDIO E MONITORIMIT	29
IV.	RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT	31
	4.1. PLANIFIKIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE	31
	4.1.1. Planifikimi i rrjeteve numerike.....	31
	4.1.2. Shfrytëzimi i dividendit digital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.....	33
	4.1.3. Planifikimi i rrjeteve analoge.....	34
	Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv) për licencimin e operatorëve të rinj, dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.	34
	4.2. MONITORIMI I SHFRYTËZIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE.....	37
	4.2.1. Operatorë radio e televizivë privatë vendorë të transmetimeve analoge tokësore dhe televizione kabllorë që u është hequr licenca se kanë ndërprerë transmetimet apo nuk kanë dalë në transmetim mbas licencimit	37
	4.2.2. Operatorë radiofonikë privatë vendorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.	38
	4.3. TRANSMETIME TË PALICENCUARA (SHFRYTËZIM I PAAUTORIZUAR I SPEKTRIT).....	39
	4.3.1. Transmetimet e “Vizion+”	39
	4.3.2. Transmetimet e Klan TV	39
	4.3.3. Transmetimet TV ABC News.....	40
	4.3.4. Operatori televiziv vendor TV JUG.....	40

4.3.5.	Transmetim sinjali televiziv analog i palicencuar.....	40
4.3.6.	Rritje e paautorizuar e fuqisë së transmetimit	40
4.3.6.1.	Transmetimet e TV Elrodi Music, Vorë.....	41
4.3.7.	Rrjete kablllore të palicencuar	41
4.3.8.	Transmetime numerike të paautorizuara në kanalet e licencuara si analoge	42
4.3.9.	Transmetimet numerike të paautorizuara	42
4.4.	OPERATORËT.....	42
4.4.1.	Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge.....	42
4.4.1.1.	Televizioni publik.....	42
4.4.1.2.	Operatorët privatë kombëtarë.....	45
4.4.1.2.1.	Operatori Kombëtar TVA.....	48
4.4.1.2.2.	Operatori Kombëtar TV KLAN.....	48
4.4.1.2.3.	Operatori Kombëtar TV TOP CHANNEL.....	50
4.4.1.3.	Operatorët privatë vendorë	52
4.4.2.	Transmetimet numerike ekzistuese.....	53
4.4.2.1.	Digitalb.....	53
4.4.2.2.	Tring.....	56
4.4.2.3.	Shijak TV.....	57
4.4.2.4.	Transmetime numerike të palicencuara të konstatuara në vitin 2010	59
4.5.	PËRGATITJET PËR TRANSMETIMET NUMERIKE.....	59
4.5.1.	Puna përgatitore për hartimin e projektit të strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike	59
4.5.2.	Puna për përfundimin e projektit të strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike.....	60
V.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN	62
5.1.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRATIVE.....	62
5.2.	MARRËDHËNIET ME JASHTË.....	65
5.3.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE GRUPET E INTERESIT	68
VI.	BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË.....	70
6.1.	REALIZIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN 2010.....	70
6.2.	GJOBAT	77
6.3.	BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE.....	77
VII.	KONKLUZIONE	78
VIII.	ANEKSET	79
	ANEKSI I - PASQYRA E GJOBAVE PËR VITIN 2010	79
	ANEKSI II - LISTA E URDHRAVE PËR EKZEKUTIM TË SUBJEKTEVE TELEVIZIVË TË DALË NË TRANSMETIM PA AUTORIZIMIN / LICENCIMIN E KKRT-SË.....	91
	ANEKSI III - ÇËSHTJET GJYQËSORE.....	83
	ANEKSI IV - LISTA E SANKSIONEVE PËR SHKELJE TË TË DREJTAVE TË TRANSMETIMIT.....	91
	ANEKSI V - PASQYRA E DETYRIMEVE TE DEBITOREVE.....	97
	ANEKSI VI - LISTA E URDHRAVE PER SUBJEKTET DEBITOR DHE ME GJOBA.....	98
	ANEKSI VII - MBULIMI I OPERATOREVE TELEVIZIVE PËR VITIN 2010 (VOLUMI 1)	
	ANEKSI VIII - MBULIMI I OPERATOREVE RADIO PËR VITIN 2010 (VOLUMI 2)	

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është përpjekur maksimalisht që të realizojë angazhimet dhe objektivat kryesorë që lidhen me ecurinë e institucionit, zbatimin e kuadrit ligjor, përsheptimin e reformës ligjore, përfundimin e strategjisë së kalimit nga sistemi analog në atë numerik, luftën kundër transmetimeve pa të drejta etj.

Gjatë këtij viti, përveç vendimeve të KKRT-së, që lidhen me respektimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e programeve, institucioni vijoi punën për hartimin e plotësimin përfundimtar të ligjit të ri për median audiovizive "Për transmetimet me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë". Tashmë ky proces është pranë përfundimit dhe projektligji i ri, që besojmë se do të miratohet së shpejti, do të luajë një rol të rëndësishëm për rregullimin e veprimtarisë së mediave audiovizive në Shqipëri.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Komiteti *ad hoc* për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, nga ana e ekspertëve të KKRT-së ka zhvilluar një punë intensive, në bashkëpunim edhe me aktoret e tjerë. Në nëntor 2010, Sekretariati Teknik miratoi projektin final, që i është dërguar për miratim Komitetit *ad hoc*.

Gjatë vitit 2010, një problem ka qenë mungesa e numrit të nevojshëm të anëtarëve të KKRT-së, gjë që krijoi në momente të caktuara një impas në punën e Këshillit dhe pamundësinë e formimit të kuorumit të nevojshëm për marrjen e vendimeve të caktuara për rreth 7 muaj. Gjithashtu, prej gati dy vjetësh në Këshill vazhdon të mbetet një vend vakant, për shkak të mosemërimit të një anëtari.

Megjithatë, pavarësisht vështirësive të shfaqura dhe problemeve të hasura, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit edhe gjatë vitit raportues, ka miratuar një tërësi aktesh dhe vendimesh, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në fushën e medias dhe në përmirësimin e peizazhit audiovizual.

Më konkretisht, veprimtaritë e kryera jepen me hollësi në këtë Raport.

II. RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR

2.1. LICENCIMI DHE ECURIA E OPERATORËVE TË LICENCUAR

Gjatë vitit 2010, KKRT ka marrë gjithsej 238 Vendime. Këto vendime lidhen kryesisht me shqyrtimin e aplikimeve për licenca apo rilicencime, kërkesave për miratim ndryshimi të dhënash në kërkesat për marrjen e licencave, dhe ankesave për sanksione, apo shqyrtimi i çështjeve e problemeve të tjera të fushës.

Licencimi i operatorëve radiotelevizivë është një nga funksionet kryesore të KKRT-së, i cili bëhet në bazë të kërkesave të subjekteve, disponibilitetit të frekuencave dhe në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Gjatë vitit 2010, KKRT ka licencuar gjithsej 23 subjekte radiotelevizive ku kryesisht, numrin më të madh e zënë operatorët radiotelevizivë kabllorë. Licencimet janë si më poshtë:

Operatorë televizivë privatë analogë vendorë (2 subjekte), operatorë radiofonikë analogë privatë vendorë (6 subjekte) dhe operatorë televizivë privatë kabllorë (15 subjekte), konkretisht si më poshtë vijon:

TV Analogë Vendorë:

1. TV Vendor "RE.AL" (Qyteti Vlorë);
2. TV Vendor "Star Plus" (Rrethi Shkodër).

Radio Analoge Vendore:

1. Radio "Greta Music Radio" (Qyteti Tiranë);
2. Radio "One" (Rrethet Tiranë-Durrës);
3. Radio "Grant" (Rrethi Shkodër);
4. Radio "Durrësi" (Prefektura Durrës);
5. Radio "Radio Energy" (zgjerim zone licencimi në Qarqet Fier -Vlorë);
6. Radio "Eagle" (zgjerim zone licencimi në qarqet Fier-Vlorë).

TV Kabllorë:

1. TV Kabllor "Voskop" (Komuna Voskop dhe Mollaj);
2. TV Kabllor "Krutja" (Komuna Krutje, Këmishtaj, Fier-Shegan, Gradishtë, Rremas, Allkaj);
3. TV Kabllor "Cakrani" (Komuna Cakran);
4. TV Kabllor "Vjosa" (Komuna Novoselë);

5. TV Kabllor "Belshi" (Bashkia Belsh);
6. TV Kabllor "Bradsat" (Komuna Bradashesh);
7. TV Kabllor "Toshkëz" (Komuna Allkaj);
8. TV Kabllor "Progres TV" (Qyteti Kavajë, Komuna Synej);
9. TV Kabllor "M&G" (Komuna Papër dhe Cërrik);
10. TV Kabllor "DCT" (Bashkia Poliçan dhe Komuna Ksamil);
11. TV Kabllor "Pupa" (Fshatrat Xengë-Mizë-Zharrnecë);
12. TV Kabllor "Vlora Cable" (Qyteti Vlorë);
13. TV Kabllor "Xhaçi" (Komuna Miras);
14. TV Kabllor "Fokus" (zgjerim zone licencimi në Komunën Libonik);
15. TV Kabllor "Star" (zgjerim zone licencimi në Bashkitë Durrës, Kavajë. Lushnjë dhe Elbasan).

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë miratuar dhe një numër i konsiderueshëm kërkesash për rinovim licence (39 subjekte), në mbështetje të ligjit nr. 8410, si dhe në mbështetje e në zbatim të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë". Rinovimi i licencave është realizuar duke respektuar disa kriterë bazë të përcaktuara në këto akte ligjore, si sjellja e operatorit gjatë periudhës së vlefshmërisë së mëparshme të licencimit, zbatimi i planit të investimeve, realizimi i mbulimit të zonës së licencimit, respektimi i kushteve të licencës, të të drejtave të transmetimit, realizimit të pagesave për licencë e taksa, paraqitjen e bilanceve vjetore, etj.

Si rezultat, u arrit që të rilicencoheshin 39 subjekte radiotelevizivë. Konkretisht, është rinovuar licenca për 19 radio private vendore dhe me përsëritës, 13 televizione private vendore dhe me përsëritës si dhe 7 televizione private kabllore si më poshtë vijon:

Radio Analoge Vendore dhe me Përsëritës

1. "Radio Valë e Kaltër";
2. "Radio Top Gold";
3. "Radio Eurostar";
4. "Radio Fieri";
5. "Radio Club FM";
6. "Radio RASH";
7. "Radio ENERGY";
8. "Radio Kontakt";
9. "Radio Nacional";
10. "Radio Ngjallja";
11. "Radio IME";
12. "Radio Alfa & Omega";
13. "Radio me përsëritës BBC";
14. "Radio Alfa";
15. "Love Radio";

16. "Radio me përsëritës DEUTSCHE WELLE";
17. "Radio Muzika Jonë";
18. "Radio Eagle";
19. "Radio Emanuel".

TV Vendorë dhe me Përsëritës

1. "TV SCAN";
2. "Nesër TV";
3. "TV Channel 7";
4. "TV Bulqiza";
5. "TV UTV Education";
6. "TV AVN";
7. "TV Tirana";
8. "TV Planet";
9. "TV Channel 1";
10. "TV KOHA";
11. "TV Vlora Channel";
12. "TV Kukësi";
13. "TV me përsëritës TV 5";

TV Kabllorë

1. "TV Kabllor Multivizion";
2. "TV Kabllor Iliria";
3. "TV Kabllor Lissus";
4. "TV Kabllor Inksusat";
5. "TV Kabllor Star";
6. "TV Kabllor Korça";
7. "TV Kabllor DEVI E.R.I";

KKRT, mbështetur në kompetencat e veta, ka marrë edhe vendime për mosdhënie licencash, mosrinovim licencash dhe heqje licencash për disa subjekte që nuk kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në licencë.

Mosrinovim licencash duke sjellë si pasojë pavlefshmërinë e licencës:

1. "Radio X" (mangësi në dokumentacionin për rinovimin e licencës);
2. "Radio 6" (mangësi në dokumentacionin për rinovimin e licencës);
3. "Tv Kabllor AVN" (pirateri, nuk ka qenë i rregullt gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës për të drejtën e transmetimit);
4. "TV Dibra Vizion" (mangësi në dokumentacionin për rinovimin e licencës dhe mosrespektim i nenit 22);
5. "TV Color" (mosshfaqje interesi për rinovimin e licencës);
6. "TV AOS" (mosshfaqje interesi për rinovimin e licencës).

Mosdhënie licencash (për mangësi në dokumentacionin e aplikimit):

1. "TV Kabllor Korça "; (zgjerim zone licencimi)
2. "Radio Autostrada" (marrje licence);
3. "Love Radio"; (për zgjerim zone licencimi)
4. "Radio DJ 96.1"; (për zgjerim zone licencimi)
5. "Radio B-94"; (për zgjerim zone licencimi)
6. "Radio Blu";
7. "Radio Apollon";
8. "City Star Radio";
9. "TV Kabllor Alfa Hajdini";
10. "TV Kabllor OREXH";
11. "TV Kabllor ARD& NET";
12. "TV Kabllor 2 ASL";
13. "TV Kabllor Fier-Seman".

Heqje ose pavlefshmëri licencash

1. "TV Scutary" (mosdalje në transmetim, neni 34, pika 4);
2. "TV Kabllor Cable TEL" (mosdalje në transmetim, neni 34, pika 4);
3. "TV Kuçova" (ndërprerje të transmetimit për më shumë se 30 ditë, neni 34, pika 5).
4. "TV Arbëria" (mbyllje e transmetimit, mospërbushje e kërkesave minimale ligjore në transmetimin e sinjalit dhe kushteve programore);
5. "TV Kabllor DI-TV" (mosshlyerje e detyrimeve financiare).

Në përputhje me ligjin 8410 dt. 30.09.1998, i ndryshuar, neni 7 pika 5 vendimet e KKRT për dhënien, mosrinovimin dhe heqjen e licencave janë botuar në Fletoren Zyrtare. **Konstatohet se, gjatë vitit 2010, nuk ka pasur ankesa në gjykatë nga ana e subjekteve të interesuar, lidhur me vendimet e KKRT-së për mosdhënie licence.**

Gjithashtu, gjatë vitit 2010, janë marrë 12 vendime lidhur me miratimin e ndryshimeve në të dhënat e subjekteve të licencuar, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 8410 dt. 30.09.1998, i ndryshuar. Sipas këtij neni, subjektet njoftojnë KKRT për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës si: ndryshimet në pronësi, në administrimin apo drejtuesin e shoqërisë, emërtimin e radios ose televizionit, ndryshime në programet që transmeton, selinë apo adresën e subjektit, dhe të tjera kushte që kanë ndryshuar te subjekti që nga momenti i licencimit. Ky nen i krijon mundësinë që KKRT të kontrollojë përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushteve të licencës nga ana e subjekteve edhe kur ndryshojnë ndonjë nga të dhënat e tyre. Konkretisht, këto ndryshime të dhënash janë si vijon:

1. Me Vendimin nr. 86, datë 28.07.2010, KKRT ka miratuar ndryshimet e të dhënave në licencën e televizionit privat kabllor "Poliçani" (kalimi i të drejtave të licencës së "TV Kabllor Poliçani", subjektit "ILCO & CO"

- sh.p.k., me ortakë Z. Xhevahir Olldashi që zotëron 50% të kuotave dhe Z. Gerald Valva që zotën 50% të kuotave).
2. Me Vendimin nr. 87, datë 28.07.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "Radio Rock" sh.p.k., licencuar nga KKRT për radion private vendore "Radio Rock" (largimi i ortakut Dritan Kotorri, shtimi i Z. Dritan Kotorri, ortak i vetëm i shoqërisë me 100% të aksioneve, administratori i shoqërisë emërohet Enver Mehmeti dhe ndryshimi i adresës së shoqërisë).
 3. Me Vendimin nr. 88, datë 28.07.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "RTV Teuta" sh.p.k., licencuar nga KKRT për TV vendor "UFO EDUCATION" (ndryshim i emrit të subjektit në "UTV Education dhe ndryshim i adresës).
 4. Me Vendimin nr. 89, datë 28.07.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e radios private vendore "Radio Alfa" (kalimi i të drejtave të licencës së "Radio Alfa", subjektit "Radio Alfa" sh.p.k., me ortak të vetëm Z. Arben Kote që zotëron 100% të kuotave).
 5. Me Vendimin nr. 95, datë 27.08.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "Radio ONE" në "Radio GRANT".
 6. Me Vendimin nr. 96, datë 27.08.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "Radio B-94" në "Eagle Radio".
 7. Me vendimin nr. 106, datë 24.09.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) së radios "Radio Rock" në "Radio Travel".
 8. Me vendimin nr. 107, datë 24.09.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) së televizionit vendor nga "Telenorba shqiptare" në "ABC NEWS".
 9. Me Vendimin nr. 127, datë 24.09.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të "Radio Nostalgja" në "Radio Klan".
 10. Me Vendimin nr. 191, datë 22.10.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e televizionit kabllor "TV Kabllor LUNA" (kalimin e licencës në emër të Z. Admir Leka person fizik).
 11. Me Vendimin nr. 197, datë 12.11.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e të emërimit të subjektit televiziv privat kabllor "TV Kabllor Bilishti" në "TVM Devolli".
 12. Me Vendimin nr. 198, datë 12.11.2010, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në shoqërinë "TV Channel 1" sh.p.k., licencuar nga KKRT për radion private vendore "Idea" (largimi i ortakëve Granit Çakërri dhe Mario Shenaj, shtimi i ortakëve Viron Mërkuri me 50% të aksioneve dhe Marjeta Mërkuri me 50 % të aksioneve, administratori i ri Marjeta Mërkuri).

Në raport me vitet e shkuara, KKRT vëren një ndërgjegjësim më të madh të operatorëve radiotelevizivë në respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga nenet 22 dhe 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

2.2. SANKSIONET NDAJ SUBJEKTEVE

Një nga detyrat kryesore dhe funksionale të KKRT-së është edhe kontrolli i respektimit të kushteve të licencës. Në bazë të 137/1 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, inspektorët e KKRT inspektojnë veprimtarinë e të licencuarve. Gjithashtu, KKRT ka kompetencë të vendosë sanksione në bazë të nenit 137 për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Inspektorët e KKRT-së kanë të drejtë të vendosin sanksione me gjobë bazuar në nenin 137/4 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, ndërsa në zbatim të nenit 137/3 të ligjit kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit: reduktimin, pezullimin ose heqjen e licencës së një subjekti radioteleviziv kur konstatohet shkelje e dispozitave ligjore. Në zbatim të këtyre dispozitave janë kryer inspektime të shpeshta tek operatorët e licencuar, por gjithashtu janë konstatuar edhe dalje në transmetim të subjekteve të ndryshëm pa licencë. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të ligjit dhe kushteve të licencës, ndaj subjekteve kundërvajtës janë ndërmarrë sanksionet përkatëse.

Shkeljet më të prekshme, gjatë vitit 2010 kanë konsistuar në daljen në transmetim pa autorizimin/licencimin e KKRT-së të operatorëve privatë radiotelevizivë kabllorë, transmetimet pa të drejta (pirateria), mosrespektimin e zonave të licencimit dhe transmetimet në frekuenca të tjera të paautorizuara. Krahas sanksioneve me gjobë, në rastet e daljeve në transmetim pa licencë, janë nxjerrë dhe urdhra që i janë dërguar për zbatim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve apo sekuestrimin e pajisjeve të këtyre subjekteve. Me hollësisht sanksionet me gjobë pasqyrohen në Aneksin 1 të këtij Raporti.

2.3. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË KKRT-së

Ekzekutimi i vendimeve ndikon drejtpërdrejt në forcimin e autoritetit të KKRT-së. Sipas nenit 137/5 të ligjit nr. 8410, vendimet e KKRT-së për heqjen e licencës, ekzekutimin e sanksioneve me gjobë dhe sekuestrimin, realizohen nga organet tatimore. Për secilin rast kanë dalë urdhrat e ekzekutimit nga Kryetari i KKRT-së, të cilat janë dërguar për zbatim në Drejtoritë Rajonale të Tatimeve si dhe është vënë në dijeni Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Nga të dhënat e vitit 2010 rezulton të jenë shlyer në mënyrë vullnetare nga subjektet vetëm 22% e numrit të gjobave të vendosura ose 5.8% e vlerës totale të tyre, ndërsa janë ekzekutuar nga Drejtoritë Rajonale të Tatimeve 6 Urdhra të KKRT-së me objekt sekuestrim pajisjesh apo shlyerje detyrimesh nga 18 Urdhra të nxjerra.

Sikurse e kemi vënë në dukje edhe ne Raportin e vitit 2009, KKRT konstaton se pjesa dërrmuese e vendimeve të saj nuk ekzekutohen nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Mosekzekutimi i vendimeve të KKRT-së ka sjellë si

pasojë uljen e autoritetit të KKRT-së tek operatorët radiotelevizivë privatë. Neglizhenca e organeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në mosekzekutimin e vendimeve të KKRT-së konstatohet në Vendimet e KKRT-së për bllokimin e aktivitetit transmetues të subjekteve radiotelevizivë të palicencuar nga KKRT (kryesisht TV Kabllorë). Edhe kur organet tatimore realizojnë mbylljen e këtyre subjekteve piratë të palicencuar nga KKRT, kemi të bëjmë thjesht me një mbyllje formale të tyre, pasi me largimin e organeve tatimore, subjektet kundërvajtës rifillojnë menjëherë aktivitetin e tyre të paligjshëm. Për sa i përket urdhrave të KKRT-së për sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjekteve kundërvajtës, pasi janë ezauruar afatet ligjore për bllokimin e tyre, organet tatimore janë plotësisht pasivë në ekzekutimin e tyre. Gjithashtu, kjo neglizhencë konstatohet dhe në ekzekutimin e sanksioneve me gjobë të vendosura nga KKRT-ja. Theksojmë se të ardhurat që merren nga vjelja e gjobave derdhen në buxhetin e shtetit.

Nga inspektimet e realizuara, gjatë vitit 2010, janë identifikuar një numër i konsiderueshëm subjektsh televizivë privatë kabllorë apo analogë, që kishin dalë në transmetim pa autorizimin e licencimin e KKRT-së. Në mbështetje të neneve 10/a, 137/2 dhe 137/5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë përpiluar urdhrat për ekzekutim sipas Aneksit 2, bashkëlidhur raportit.

Siç rezulton nga sa më sipër, bashkëpunimi me Drejtorinë e Tatimeve për ekzekutimet e Urdhrave të KKRT-së nuk ka funksionuar siç duhet. Duke qenë se mosekzekutimi i sanksioneve të vëna nga KKRT-ja, jo vetëm ka krijuar probleme financiare, por njëkohësisht ka ulur edhe autoritetin e KKRT-së, në muajin tetor 2010, u dërgua në Kuvend një ndryshim i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me konkretisht u parashikua një institucion tjetër (Shërbimi Përmbarimor), për të kryer ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së. Shtojmë se kjo është një zgjidhje e bërë së fundmi në legjislacionin shqiptar edhe nga institucione të tjera të pavarura (neni 34 i ligjit nr. 10317, dt. “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, parashikon ndryshimin e organit ekzekutues të vendimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare, nga Tatimet të Shërbimi Përmbarimor).

2.4. ÇËSHTJET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2010, KKRT ka qenë palë në procese gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme me operatorë radiotelevizivë. Në pjesën më të madhe ankimohen në gjykatë vendimet e KKRT-së lidhur me moslicencime, mosrinovime licence, vendosje sanksionesh, etj.

Më konkretisht, KKRT është palë në 46 procese gjyqësore, nga të cilat 41 janë në proces gjykimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga Gjykatat e Apelit të Vlorës dhe Tiranës dhe në Gjykatën e Lartë. Ndërsa 5 janë çështje të përfunduara. Pjesa më e madhe e këtyre çështjeve janë të trashëguara nga vitet paraardhëse, por zgjatja e procedurave gjyqësore ka bërë që gjykimi i tyre të vazhdojë dhe gjatë vitit 2010.

Një pasqyrim, në mënyrë të hollësishme, i çështjeve gjyqësore, që aktualisht janë në gjykim, jepet në Aneksin 3.

2.5. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË TRANSMETIMIT

Pronësia intelektuale dhe mbrojtja e saj përbëjnë një nga sfidat me të cilën Shqipëria ndeshet në kuadër të plotësimit të kriterëve e kushteve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është pjesë. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit i ka kushtuar një vëmendje të posaçme mbrojtjes që Shqipëria duhet t'i sigurojë pronësisë intelektuale, konkretisht neni 73 i saj parashikon që vendi ynë duhet të marrë masat e duhura për të siguruar një nivel mbrojtjeje si në vendet e BE. Një nga institucionet e angazhuar me monitorimin dhe mbrojtjen e një prej degëve të pronësisë intelektuale, konkretisht të të drejtave të autorit, është edhe Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit. KKRT vepron në një fushë të kufizuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit, specifikisht të drejtat e transmetimit. Kompetencat e KKRT-së lidhur me masat dhe procedurat që duhet të ndiqen prej kësaj të fundit për respektimin e të drejtave të transmetimit rrjedhin nga ligji organik i KKRT-së, ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në bazë të këtij ligji, mosrespektimi i të drejtave të transmetimit nga subjektet radiotelevizivë, konkretisht transmetimi i programeve të cilat nuk i kanë prodhuar vetë dhe për të cilat nuk kanë marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi nga subjektet e tjera radiotelevizive, prodhuesit apo shpërndarësit e autorizuar të tyre, i jep të drejtë KKRT të ndërmarë sanksione me gjobë ndaj subjekteve shkelëse.

KKRT si një nga institucionet e përfshira në mbrojtjen e pronësisë intelektuale me qëllim arritjen e rezultateve sa më efikase ka bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën e saj me institucionet e tjera të përfshira në këtë proces. Konkretisht, me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, si institucion lider në mbrojtjen e të drejtave të autorit, KKRT gjatë vitit 2010 ka intensifikuar marrëdhëniet dhe ndihmën e ndërsjellë për shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave me qëllim verifikimin e vërtetësisë së dokumentacionit mbi të drejtat e transmetimit të paraqitur pranë KKRT-së nga operatorët radio-televizivë. Dokumentacioni për të drejtat e transmetimit para se të dorëzohet në KKRT duhet të regjistrohet e të certifikohet nga ZSHDA.

Një problem, i cili nuk ka gjetur ende zgjidhje, është fakti se pjesa më e madhe e dokumentacionit të të drejtave të transmetimit (kontratë shitjeje, shkëmbimi, dhurimi), që depozitohet në KKRT nga operatorët radiotelevizivë, nuk janë të regjistruara dhe certifikuara nga ZSHDA.

Respektimi i të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me garantimin e konkurrencës së ndershme dhe ekuilibrimin e tregut mediatik, misionet këto të institucionit të KKRT-së. Respektimi i të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale (të drejtat e transmetimit dhe të drejtat e autorit) mbetet një çështje delikate, që sfidon jo vetëm KKRT-në por edhe institucione të tjera të përfshira. Kjo për shkak se pronësia intelektuale është një fushë e re në Shqipëri dhe praktika lidhur me respektimin apo mbrojtjen e saj mungon. Lufta ndaj piraterisë do të mbetet një nga çështjet që do të vazhdojë të sfidojë KKRT-në në të ardhmen e afërt.

Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në kontrollin efektiv të KKRT-së lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit. Së pari, disa subjekte radiotelevizivë janë jashtë kontrollit efektiv të KKRT-së, çka e bën garantimin e të drejtës së autorit të vështirë. Pirateria televizive ekziston në një masë më të konsiderueshme të subjektet radiotelevizivë që operojnë në zona të thella, dhe që janë larg mbikëqyrjes e monitorimit të KKRT-së. Nga ana tjetër, pamundësia për të verifikuar burimin e vërtetë të mbajtësit të së drejtës së autorit, të vërtetësisë dhe origjinalitetit të kontratave, apo të të drejtave që realisht zotërojnë shoqëritë e ndryshme distributore, kanë ndikuar aktivitetin e KKRT-së në këtë drejtim.

Pavarësisht vështirësive që ndesh gjatë veprimtarisë së saj, KKRT, gjatë vitit 2010 ka intensifikuar inspektimet në terren, nëpër të gjithë territorin e vendit për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave të transmetimit nga ana e subjekteve televizivë kabllorë. Si rezultat i kontrolleve të ushtruara gjatë gjithë vitit janë ndëshkuar me sanksionin e paralajmërimit dhe të gjobës një numër i konsiderueshëm televizioneve kabllorë, për të cilat ka rezultuar se kanë shkelur të drejtat e transmetimit.

Në krahasim me vitin 2009 janë rritur ndjeshëm kontrollet e inspektimet dhe rrjedhimisht edhe sanksionet e marra për shkeljet e konstatuara të të drejtave të transmetimit. Konkretisht gjatë vitit 2010 KKRT ka vendosur 54 sanksione me gjobë dhe 33 sanksione me paralajmërim (bashkëlidhur Aneksi 4, me sanksionet e marra gjatë vitit 2010).

Për të përballuar sfidën e mbrojtjes së të drejtave të transmetimit është i nevojshëm hartimi i një strategjie. Kjo strategji duhet të synojë sensibilizimin e të gjithë operatorëve në transmetim, për të respektuar ata vetë ligjet që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale (në përgjithësi) dhe të drejtat e transmetimit (dhe të ritransmetimit) të programeve radiotelevizive (në veçanti).

KKRT është përfshirë në strategjinë kombëtare të pronësisë intelektuale të miratuar me VKM Nr. 760, date 01.09.2010 *“Për miratimin e strategjisë kombëtare për pronësinë intelektuale dhe industriale 2010 – 2015”*, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 163, date 08.12.2010. Sipas kësaj strategjie, KKRT konsiderohet si një nga institucionet e cila mund të kontribuojë në luftën kundër piraterisë dhe si pasojë është një institucion garant i të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale. Sipas kësaj strategjie faktor i rëndësishëm është bashkëpunimi mes të gjitha institucioneve të përfshira në mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Lidhur me të drejtat e transmetimit, KKRT duhet të intensifikojë bashkëpunimin me ZSHDA, si institucioni kryesor i cili monitoron dhe kontrollon respektimin e të drejtave të autorit, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, i cili është organi që bën ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së.

Për monitorimin dhe drejtimin e zbatimit të kësaj strategjie është ngritur grupi ndërinstitutional i punës, ku Kryetari i KKRT-së është një nga anëtarët e këtij grupi. KKRT, ashtu si edhe institucionet e tjera përgjegjëse, do të raportojë pranë METE-s mbi nivelin e zbatimit të masave të përcaktuara në strategjinë dhe planin e veprimit, për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Strategjia e re e respektimit të ligjshmërisë, që lidhet me pronësinë intelektuale, kërkon edhe ndryshime në legjislacionin që rregullon punën e KKRT-së. Gjithashtu, nevojë për ndryshime rrënjësore kanë edhe rregulloret e deritanishme, veçanërisht ato që lidhen me dhënien e licencave dhe të dokumentimit të programeve jo prodhime të vetë operatorëve etj.



III.PROGRAMACIONI

3.1. SITUATA PROGRAMORE NË MEDIAN ELEKTRONIKE

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, gjatë vitit 2010, ka intensifikuar përpjekjet për të rritur rolin dhe ndikimin e vet në zhvillimet dhe cilësinë e programacionit të operatorëve radiotelevizivë. Këto përpjekje kanë pasur si synime kryesore realizimin e vijueshëm të strukturave programore sipas licencave përkatëse, zbatimin e ligjshmërisë dhe të standardeve etike të komunikimit si pjesë e rëndësishme e platformave dhe e përmbajtjes së programeve, si dhe rritjen e cilësisë së programeve të operatorëve të licencuar. Për këtë qëllim, është ngulmuar në domosdoshmërinë e zbatimit të ligjit dhe kërkesave të licencës për programet informative, kulturore ose argëtuese, respektimin e normave të deontologjisë së mediave dhe krijimin e një raporti gjithnjë e më të pranueshëm mes programeve komerciale dhe programeve edukative.

3.1.1. Ligjshmëria dhe struktura programore

Në veprimtarinë e vet njëvjeçare, edhe në fushën e programeve, KKRT ka kërkuar nga të gjithë operatorët zbatimin me rigorozitet të legjislacionit në fuqi, veçanërisht të nenit 22 të Kushtetutës së Shqipërisë, që garanton lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit, të radios dhe televizionit dhe ndalon censurën paraprake të mjeteve të komunikimit. Në këtë veprimtari janë mbajtur gjithnjë parasysh parimet themelore të veprimtarisë radiotelevizive, të sanksionuara, veç të tjerash, në nenin 36 të ligjit nr. 8410, datë 30. 09. 1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”. Liria në përzgjedhjen e programeve dhe respektimi i pavarësisë editoriale nga organi rregullator mund të quhen, në nivelin e sotëm të zhvillimit të medias elektronike, standarde jo vetëm të kërkuara nga ligji, por edhe të realizuara në nivele të kënaqshme. Nga ana tjetër, KKRT ka pasur në qendër të vëmendjes larminë dhe shumëllojshmërinë e programeve, respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e fëmijëve e të rinjve si dhe çështjet etike.

Në fushën e programeve, dukuritë dhe problematikat bashkëkohore gjejnë vend në projektligjin e ri në përputhje me rekomandimet e BE-së, sidomos me ato të *Direktivës AVMS*, në ndonjë rast të përshtatura sipas realitetit mediatik shqiptar. Në thelb të tyre qëndron riafirmimi i shtyllave të modelit europian audiovizual si shumëllojshmëria kulturore, mbrojtja e të miturve, mbrojtja e konsumatorit, pluralizmi mediatik, lufta kundër racizmit dhe diskriminimit me baza fetare, sigurimi i pavarësisë së rregullatorëve mediatikë kombëtarë, larmia kulturore dhe gjuhësore.

Kontributi i KKRT-së, në këtë drejtim, ka të bëjë kryesisht me plotësimin e hapësirës ligjore për dukuri programore si vendosja e produktit, me statusin ligjor e funksionimin e Këshillit të Ankesave, me referencat në ligj për domosdoshmërinë e respektimit të parimeve themelore të veprimtarisë radiotelevizive. Një tregues shumë i rëndësishëm, për vetë specifikën dhe rëndësinë e tij në kuadrin e integritit dhe përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me atë të vendeve të BE-së, është përfshirja, në projektligj, e neneve për veprat audiovizuale evropiane. Cilësimi dhe parimi i mbrojtjes së veprave audiovizuale evropiane përkon me respektimin rigoroz të ligjit, me mbrojtjen e mbështetjen e diversitetit kulturor e gjuhësor, me përkrahjen e krijimtarisë që evokon identitetin e kulturave të ndryshme në erën globale e integruese. Projektligji përfshin gjithashtu zhvillimet e deritanishme pozitive, fluksin e suksesshëm të teknologjive të reja dhe vënien e tyre në shërbim të larmisë, shumëllojshmërisë së strukturave programore.

Në veprimtarinë e vet njëvjeçare KKRT ka pasur parasysh përfundimet dhe kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së KKRT-së për vitin 2009 ku theksohet, ndër të tjera, domosdoshmëria e zbatimit të ligjit dhe normave etike, sidomos në programet propagandë të ish regjimit komunist. Për këtë, si dhe për programet që trajtojnë respektimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave e të të miturve, veç rolit të KKRT-së, nevojitet një sensibilizim më i madh i opinionit publik dhe rritje e përgjegjësisë profesionale e qytetare të operatorëve radiotelevizivë.

Rritja e përgjegjësisë së operatorëve me licencë kombëtare për zbatimin e kërkesave të ligjit në fushën e programeve dhe respektimin e standardeve etike ka qenë dhe mbetet një objektiv parësor i KKRT-së. Statusi ligjor, burimet financiare dhe njerëzore, potencialet krijuese e profesionale, përmbajtja dhe cilësia e programeve i vënë operatorët kombëtarë Tv Klan dhe Top Channel në rolin e liderit në tregun mediatik shqiptar. Si të tillë ata gëzojnë privilegjin dhe përgjegjësinë e një audience gjithnjë në rritje, nga njëra anë dhe, në anë tjetër, të “shembullit” apo të “shkollës” për operatorët e tjerë lokalë. Këta operatorë paraqiten në treg me potenciale më të vogla, por me përgjegjësi e mision gjithaq të rëndësishëm, sidomos për komunitetet vendore e rajonale ku transmetojnë. KKRT me autoritetin që i jep ligji si organ mbikëqyrës e rregullator, është përpjekur të vendosë një komunikim të vazhdueshëm me operatorët radiotelevizivë, me aktorët e tjerë të medias dhe me publikun. Ky komunikim nuk nënkupton vetëm praktikën rutinore administrative e institucionale, por para së gjithash, trajtimin e çështjeve thelbësore e të qenësishme të veprimtarisë radiotelevizive, të problematikave të strukturës e të përmbajtjes së programeve, që burojnë vetiu prej kontradiktës së përhershme midis të drejtës për informim dhe të drejtës për respektim të lirive themelore të individit.

Strukturat programore përcaktojnë, përgjithësisht, “fytyrën” e mediave elektronike, janë pasaporta e identitetit vetjak të operatorëve. Në këtë

këndvështrim, panorama e sotme mediatike ofron hapësira për lloje të ndryshme operatorësh dhe për shumëllojshmëri programesh të ndryshme. KKRT vëren se, përpos një zhvillimi të rëndësishëm sasior, vijon të mbizotërojë dukuria e shpërpjestimit të radiotelevizioneve tematike. Në strukturën dhe përmbajtjen programore të transmetuesve ende dominojnë televizionet tematike të llojit informativ e muzikor, (10 të tilla vetëm në kryeqytet) ndërkohë që nuk kemi ende kërkesa për televizione të formateve të tjera mirëfilli shkencore, edukative, artistike apo sportive. Treguesit pozitivë, edhe në një treg mediatik relativisht të vogël si ai shqiptar, nuk mungojnë. Edhe gjatë këtij viti, përveç Televizionit Publik Shqiptar, në televizionet private kombëtare “Klan” e “Top Channel” është vënë re rritja e profesionalizmit dhe besueshmërisë. Rastet e suksesshme të televizioneve “SCAN”, me format e profil ekonomik dhe “UFO EDUCATION (UTV)” me emisionet edukative, apo hyrja në treg e televizionit informativ ABC janë një shembull pozitiv i shfrytëzimit të hapësirës ligjore e mediatike në dobi të kërkesave e të interesave të teleshikuesve. Nga ana tjetër, KKRT, siç është vënë re edhe më parë, e konsideron mangësi të theksuar të panoramës mediatike shqiptare faktin e mungesës së një operatori radioteleviziv për fëmijë e të rinj. Këtë boshllëk të ndjeshëm e të pamotivuar, me gjithë përpjekjet pozitive, nuk mund ta plotësojnë as emisionet e veçanta të Televizionit Publik, as spektaklet për fëmijë, sado të suksesshme, në televizionet private kombëtare dhe as kanalet për fëmijë e të rinj në platformat numerike “Digital” e “Tring”, që transmetojnë kryesisht filma të huaj të përkthyer.

3.1.2. Dukuri të përmbajtjes dhe etikës së programeve

Synimi i KKRT-së për zbatimin me përpikëri të ligjit dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar për median me atë të vendeve të Bashkimit Europian, ka ndikuar në zhvillimet e deritanishme pozitive, në përmbushjen e standardeve mediatike të domosdoshme për proceset e përshpejtuara integruese që po kalon Shqipëria. Operatorët radiotelevizivë, veçanërisht operatorët kombëtarë kanë krijuar më shumë hapësira për programe që trajtojnë probleme të mprehta shoqërore, programe që u drejtohen njerëzve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, grave dhe fëmijëve, programe për përfshirjen dhe integrimin e minoriteteve etnike dhe kulturore, respektimin e diversitetit fetar, racor, gjuhësor, seksual etj. Por duhet theksuar se, si pasojë e zhvillimeve social ekonomike në vend, po edhe për meritë të vetë medias, tashmë audienca aq e lakmuar ka kërkesa gjithnjë e më të larta për nivele cilësore profesionale të programeve mediatike. “Kulti” i telekomandës i vë operatorët përpara imperativit për të ideuar e krijuar programe me përmbajtje e standarde bashkëkohore, të realizuara në klimën e një konkurrence të ndershme. Realiteti i sotëm mediatik shqiptar dëshmon se programet më të ndjekura janë pikërisht ato që, përgjithësisht, respektojnë parimet themelore të veprimtarisë radiotelevizive dhe deontologjinë e mediave.

Gjatë vitit 2010, për monitorimin, shqyrtimin, analizën dhe përfundimet që lidhen me çështje programore e të deontologjisë së mediave, KKRT është fokusuar në dy drejtime:

- a) në monitorimin sasior, të kryer sipas detyrimeve ligjore. Kjo është një praktikë e konsoliduar, e cila përfshin monitorimin e detajuar të edicioneve informative të televizioneve kombëtare, dhe
- b) në vizionimin e herëpashershëm tematik apo cilësor të programeve të ndryshme.

Ky vizionim përfshin edhe trajtimin e ankesave të qytetarëve për probleme të respektimit të ligjit e të kërkesave e normave etike në programet mediatike, si të drejtat e fëmijëve dhe grave, respektimi i privatësisë, të drejtat e pakicave, të drejtat e njeriut, gjuha letrare kombëtare etj. Në këtë proces, veçanërisht për këtë vit, është përfshirë, përmes sondazheve e vizionimeve edhe një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjes së programeve të disa televizioneve lokale, që transmetojnë në Tiranë e në rrethe.

Në përfundimet dhe problematikat e monitorimeve të kryera për përmbajtjen e programeve janë mbështetur ndryshimet dhe propozimet e KKRT-së, të përmendura më sipër, për projektligjin e ri të medias elektronike. Nga njëra anë, kjo gjë dëshmon rëndësinë e përmbajtjes së programeve, nga ana tjetër do të thotë se përmbajtja, kompeticioni i vazhdueshëm dhe cilësia e transmetimit nuk janë gjithnjë në përpjestimet e duhura me kërkesat e publikut dhe deontologjinë e mediave. Sigurimi i audiencës me çdo kusht është lëshimi i parë profesional që i bëhet përmbajtjes e cilësisë së programeve. Dukuria më e ndjeshme është uniformiteti i programeve, dallimet nga një media në tjetrën janë shpesh formale, jo konceptuale e përmbajtësore. Ky uniformitet shfaqet në programet informative, në emisionet që kanë në qendër debatin e analizën politike, madje edhe në programet kulturore e argëtuese. Për vetë specifikën e saj, veprimtaria radiotelevizive është e tillë që, edhe nëse formalisht e zbaton ligjin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të mos plotësojë standardet etike dhe profesionale. Komunikimi mediatik, pavarësisht nga lloji i programit ka në thelb respektimin e privatësisë së individit, të të drejtave të njeriut, të çështjeve të etikës e të moralit të një shoqërie në një stad të caktuar zhvillimi.

Përmirësimet në përmbajtjen e programeve dhe në kulturën e komunikimit janë të dukshme, por KKRT ndalet pikërisht në ato raste që përbëjnë dukuri shqetësuese, ca më tepër kur shfaqen në media kombëtare, në programe me audiencë të konsoliduar e të konsiderueshme. I tillë është rasti i programit informativ-argëtues “Fiks Fare”. Raportime të këtij emisioni, për qendrat e ndihmës dhe trajtimit të viktimave të dhunës, sidomos të dhunës në familje, (strehëzat) u bënë objekt i një ankese të përfaqësive diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë në Tiranë. KKRT, duke e vlerësuar maksimalisht këtë problem, e monitoroi imtësisht emisionin dhe përmes Këshillit të Etikës,

ndërmori një komunikim administrativ, por edhe profesional me operatorin kombëtar Top Channel. U theksua ndjeshmëria e lartë e opinionit publik ndaj viktimave të dhunës, si problem i mprehtë i shoqërisë shqiptare, roli, kontributi dhe detyra e medias në këtë drejtim. Për rastin në fjalë u konstatua anashkalim i kërkesave të ligjit për respektimin e privatësisë e mbrojtjen e të miturve dhe pasaktësi e nënvleftësim në raportimin për punën dhe misionin e institucioneve bamirëse që kujdesen për viktimat e dhunës, trafikimit e abuzimeve. Lidhur me këtë problematikë, KKRT i kërkoi institucionalisht çdo operatori radioteleviziv që, në përmbajtjen e programeve, të zbatojë me përgjegjësi e përpikëri legjislacionin në fuqi, kërkesat, normat dhe standardet etike e profesionale.

Në këtë kuadër është komunikuar zyrtarisht edhe me televizionin “Vizion +” për emisionin “Zonë e lirë”, ku i është tërhequr vëmendja për keqpërdorim të gjuhës, shkelje të etikës së komunikimit dhe mosrespektim të rregullores për vendosjen e shenjave paralajmëruese në ekran.

Dukuri të tilla ose të përafërta, në përmbajtjen e programeve, shfaqen edhe në emisionet kulturore, në varietete artistike e satirike, në programet me natyrë argëtuese etj. KKRT është ndalur në vizionimin e evidentimin e atyre rasteve kur në emisione të këtij lloji, edhe pse të fushës kulturore, shkelet e dëmtohet pikërisht kultura e komunikimit, kultura gjuhësore, nëpërkëmben normat e etikës dhe dëmtohet shëndeti moral e mendor i teleshikuesve adoleshentë e të mitur. Gjithashtu, KKRT vëren se, për vetë natyrën e tyre, programe si “Portokalli”, “2XL” “Zonë e lirë” apo Reality Show “Big Brother Albania” kanë audiencë të lartë. Po kaq e lartë duhet të jetë edhe përgjegjësia e vëmendja e organizatorëve, drejtuesve, redaktorëve e gazetarëve për respektimin e standardeve etike në përmbajtjen e këtyre programeve. Si detyrim etik e moral, profesional e qytetar, si përkushtim e vlerësim ndaj nivelit kulturor e gjuhësor të publikut, por edhe si vetëdijshmëri në rritje për fazën aktuale të zhvillimit e nivelit të mediave që përfaqësojnë. Historia dhe praktika e mediave evropiane më në zë dëshmon se Kodet e Etikës, kur zbatohen e funksionojnë realisht si mekanizma vetërregullues, luajnë një rol parësor në përcaktimin e standardeve bashkëkohore të programeve të operatorëve radiotelevizivë.

3.1.3. Programet për fëmijë, ligji dhe deontologjia

Zbatimi i ligjshmërisë në platformat programore, në emisionet dhe spektaklet e posaçme për fëmijë është pjesë shumë e rëndësishme e funksionit dhe veprimtarisë mbikëqyrëse e rregullatore të KKRT-së. Theksojmë se ligji në fuqi, në këtë drejtim, shprehet në mënyrë eksplicite e nuk ka vend për ekuivoke. Të vetëdijshëm për këtë, operatorët radiotelevizivë kanë shtuar përpjekjet për respektimin rigoroz të kërkesave ligjore, të akteve e rregulloreve përkatëse të KKRT-së për këto çështje. Nga monitorimi e vizionimi i

herëpashershëm i programeve të mirëfillta për fëmijë nuk rezultojnë shkelje të drejtpërdrejta të ligjit. Madje, vitin e fundit, sidomos në programet e operatorëve kombëtarë, vihet re një përkujdesje më e madhe edhe ndaj deontologjisë së këtyre programeve. Kjo ka lidhje me respektimin e legjislacionit tonë dhe të konventave për fëmijët e të rinjtë, me përgjegjësinë dhe vëmendjen ndaj standardeve etike kur programet u drejtohen këtyre grupmoshave. Edhe në këto lloj programesh mund të ketë probleme të komunikimit, të nivelit kulturor e profesional, të njohjes së psikologjisë e interesave, por ato nuk prekin e nuk dëmtojnë shëndetin moral e mendor të fëmijëve e të të rinjve.

KKRT kërkon të tërheqë vëmendjen e operatorëve dhe të opinionit publik se dëmtimet e mundshme të fëmijëve e të të rinjve, nga programet e medias, vijnë nga dy drejtime të tjera:

- a) Nga programe të operatorëve radiotelevizivë, që nuk u drejtohen drejtpërdrejt fëmijëve, dhe
- b) nga aksesit i pakontrolluar që kanë fëmijët e të rinjtë në faqet on line të medias së re.

Në programet e llojit të parë, që nuk u drejtohen drejtpërdrejt fëmijëve, hyjnë programet informative, programet argëtuese, sidomos ato satirike e humoristike, filmat me skena dhune e seksi, përmbajtja e disa lloj reklamash etj. Përmbajtja e tyre mund të dëmtojë tërthorazi shëndetin moral e mendor të fëmijëve, formimin e edukimit kulturor e sidomos gjuhësor të tyre. KKRT ka kërkuar në vijimësi, nga të gjithë operatorët radiotelevizivë, zbatimin me rreptësi të kërkesave të ligjit dhe të rregullores për vendosjen e shenjave paralajmëruese në këto lloj programesh, për respektimin e “orës-kufi”, për komentet sqaruese e paralajmëruese etj. Ende ka raste të keqpërdorimit të skenave të dhunës, të mosnjohjes e të moszbatimit të deontologjisë së medias, në edicionet informative, në kronikat me dhe për fëmijë, në ritransmetimet e varieteve, emisioneve-debat, filmave, etj. Përtej zbatimit të detyruar të ligjit, për këto lloj programesh merr një rëndësi të dorës së parë ndërgjegjësimi i operatorëve që i transmetojnë për domosdoshmërinë e njohjes dhe zbatimit të rregullave të deontologjisë së medias. Përgjegjësia e operatorëve ndaj tërësisë së rregullave etike dhe morale që burojnë nga tradita, nga përkatësia kombëtare e qytetare dhe nga kritere të rrepta e të pranuar profesionale mund të plotësojë fare mirë boshllëkun e përkohshëm ligjor dhe mungesën e sanksioneve për këto çështje.

Për programet që shihen apo shfaqen *on line*, në median e re, mungon krejtësisht hapësira ligjore. Edhe nenet e Kushtetutës që ndalojnë pornografinë dhe veprimtarinë antikushtetuese nuk respektohen, ca më pak mund të presim respektim të deontologjisë, të kodeve e të parimeve etike. Në internet transmetohen filma, video e materiale të tjera të shumëllojshme, për të cilat për shkak të zhvillimit marramendës të teknologjisë së komunikimit, edhe në

vende më të zhvilluara se i yni, vetëm kohët e fundit janë miratuar ligjet përkatëse. Aksesit i fëmijëve dhe adoleshentëve në këto lloj programesh është krejtësisht i pakontrolluar, problemet që dalin nga përmbajtja e këtyre programeve janë alarmante, pasi përdoruesit, pra konsumatorët, janë krejtësisht të pambrojtur. Tashmë kjo çështje është nga më të ndjeshmet edhe për opinionin publik dhe shumë aktorë të medias. KKRT është e mendimit se kjo situatë, duhet të jetë një nga shkaqet kryesore të miratimit në një kohë sa më të afërt të projektligjit të ri për transmetimet me zë e figurë, që të parashikojë rregullimet dhe sanksionet përkatëse për përmbajtjen e programeve që transmetohen *on line*.

3.1.4. Programet në Radiotelevizionin Publik

Në ndryshim nga mediat private kombëtare, statusi i veçantë, funksioni dhe detyrimet specifike të përcaktuara në ligj, i kanë imponuar Radiotelevizionit Publik një strukturë programore më tradicionale. Kjo strukturë ka në themel kushtëzimet që burojnë prej funksionimit si transmetues publik, me detyrime të qarta ndaj taksapaguesve, për realizimin e misionit edukativ, atdhetar e kulturor. Në këto drejtime, në panoramën e sotme mediatike shqiptare, RTSH zë një vend të rëndësishëm. Pikërisht për këtë, KKRT ka ndjekur me vëmendje zhvillimet dhe dukuritë programore të RTSH-së për vitin 2010.

Radiotelevizioni Publik vijon të mbetet operatori me arritje të konsoliduara në pikëpamje të zbatimit të ligjit, të respektimit të parimeve themelore të veprimtarisë radiotelevizive në fushën e përmbajtjes, por edhe të deontologjisë e të kulturës së komunikimit. Struktura dhe përmbajtja e programeve të tij synon të përcjellë mesazhe të qëndrueshme kulturore, artistike, edukative në gjithë hapësirën shqiptare, për dëgjues e shikues të shtresave, formimeve, grupmoshave e interesave të ndryshme e të shumëllojshme. Në programet e RTSH-së, të çfarëdo lloji qofshin, tregohet kujdes për respektimin e normave të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit të standardit gjuhësor të shqipes, të kulturës së debatit dhe nuk gjen shkelje të etikës e të dinjitetit të teleshikuesve. Këto dhe cilësi të tjera, padyshim që janë një vlerë e pamohueshme, siç është ruajtja e një niveli profesional dhe shmangia e programeve komerciale. Por nga ana tjetër, kjo nuk justifikon një lloj klisheje, ngurtësimi apo mungese fleksibiliteti në disa programe të RTSH-së. Konkurrenca e mediave të tjera, përdorimi efikas i teknologjive të reja prej tyre, sidomos në programet informative, e vë këtë operator përballë kërkesave të një tregu mediatik gjithnjë e më dinamik.

Një detyrim i rëndësishëm ligjor i radiotelevizionit publik është realizimi e transmetimi i programeve për pakicat kombëtare dhe kategori e shtresa të veçanta shoqërore si personat me aftësi të kufizuara, personave të abuzuar, fëmijëve e grave të dhunuara, programe këto që pavarësisht se janë mbuluar, sërish mbetet vend për përmirësim.

3.2. PROGRAMET INFORMATIVE

Bazuar në nenin 7, pika 2 të Ligjit Nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është realizuar edhe gjatë vitit 2010 monitorimi i edicioneve informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë. Po ashtu është mbikëqyrur edhe transmetimi i reklamave nga gjithë operatorët radiotelevizivë gjatë vitit 2010 në përputhje me kërkesat ligjore.

Më poshtë jepen pasqyrat me të dhënat e monitorimit të programeve informative gjatë vitit 2010.

3.2.1. Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha e plotë

Referuar monitorimit, në lidhje me "**kohën e plotë**" dhënë institucioneve qendrore dhe subjekteve politike, krahasuar midis operatorëve radiotelevizivë, të dhënat paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR EDICIONET INFORMATIVE Koha e Plotë për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në %) Janar - Dhjetor 2010						
Subjektet	OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		
PRESIDENTI		4,19%	2,46%	5,08%		7,21%
KRYEMINISTRI		23,82%	26,00%	14,76%		24,17%
QEVERIA		32,50%	30,17%	15,71%		26,08%
PARLAMENTI		9,27%	7,16%	9,01%		9,46%
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		12,15%	12,81%	6,66%		9,09%
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË (PS)		13,11%	16,45%	42,97%		20,03%
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)		3,14%	3,09%	2,77%		2,86%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		0,57%	0,44%	0,35%		0,14%
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)		0,00%	0,11%	0,43%		0,08%
PARTIA DEMOKRACI DHE UNITET (PDU)		0,41%	0,46%	0,33%		0,23%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		0,05%	0,00%	0,00%		0,00%
LËVIZJA DEMOKRISTIANE (LDK)		0,01%	0,04%	0,05%		0,03%
LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR (LZHK)		0,00%	0,02%	0,00%		0,06%
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)		0,03%	0,00%	0,00%		0,01%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		0,02%	0,00%	0,00%		0,00%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)		0,01%	0,22%	0,13%		0,05%
PARTIA DEMOKRATIKE PËR INTEGRIM (PDI)		0,04%	0,04%	0,20%		0,04%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		0,01%	0,02%	0,20%		0,15%
PATIA E BALLIT KOMBËTAR (PBK)		0,11%	0,02%	0,00%		0,00%
PATIA E BALLIT KOMBËTAR DEMOKRAT (PBKD)		0,24%	0,04%	0,00%		0,00%
PARTIA G99 (G99)		0,00%	0,00%	0,36%		0,00%
PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT (PLL)		0,24%	0,17%	0,11%		0,15%
PARTIA PËR LIGJ DHE DREJTËSI (PLD)		0,03%	0,21%	0,63%		0,14%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË (PSD)		0,02%	0,09%	0,24%		0,01%
PARTIA SOCIALISTE 91 (PS 91)		0,00%	0,00%	0,00%		0,00%
PARTI TË TJERA		0,02%	0,00%	0,02%		0,00%
SHUMA		100,00%	100,00%	100,00%		100,00%

Edicionet kryesore informative të radios kombëtare “Radio +2” nuk janë monitoruar gjatë vitit 2010, pasi ende nuk ka edicione kryesore të plota lajmesh dhe mungon sinkroni si element i rëndësishëm i lajmit.

3.2.2. Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha sinkron

Referuar monitorimit, në lidhje me “kohën sinkron” dhënë subjekteve politike dhe institucioneve qendrore, krahasuar midis vetë operatorëve radiotelevizivë, të dhënat paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR EDICIONET INFORMATIVE Koha Sinkron për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (<i>koha në %</i>) Janar - Dhjetor 2010						
Subjektet OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		RAD TIRANA	TOP ALB RAD
PRESIDENTI	2.44%	1.80%	3.65%		3.61%	4.05%
KRYEMINISTRI	23.54%	26.30%	14.87%		23.03%	18.09%
QEVERIA	30.62%	30.07%	16.44%		23.21%	18.07%
PARLAMENTI	3.56%	3.06%	2.73%		4.04%	2.56%
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)	17.27%	17.40%	8.73%		13.90%	8.31%
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË (PS)	17.04%	16.59%	47.10%		27.64%	43.33%
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)	3.77%	3.35%	3.22%		3.30%	3.55%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)	0.69%	0.41%	0.34%		0.18%	0.20%
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)	0.01%	0.07%	0.38%		0.10%	0.18%
PARTIA DEMOKRACI DHE UNITET (PDU)	0.28%	0.29%	0.39%		0.29%	0.45%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)	0.05%	0.00%	0.00%		0.00%	0.00%
LËVIZJA DEMOKRISTIANE (LDK)	0.01%	0.06%	0.04%		0.00%	0.00%
LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR (LZHK)	0.00%	0.00%	0.00%		0.07%	0.00%
PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)	0.04%	0.00%	0.00%		0.00%	0.00%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)	0.02%	0.00%	0.00%		0.00%	0.00%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPËRISË (PDSSH)	0.00%	0.15%	0.09%		0.04%	0.16%
PARTIA DEMOKRATIKE PËR INTEGRIM (PDI)	0.05%	0.00%	0.16%		0.03%	0.11%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)	0.00%	0.00%	0.21%		0.23%	0.27%
PATIA E BALLIT KOMBËTAR (PBK)	0.09%	0.03%	0.07%		0.00%	0.00%
PATIA E BALLIT KOMBËTAR DEMOKRAT (PBKD)	0.27%	0.06%	0.00%		0.00%	0.00%
PARTIA G99 (G99)	0.01%	0.00%	0.37%		0.00%	0.00%
PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT (PLL)	0.18%	0.12%	0.02%		0.02%	0.00%
PARTIA PËR LIGJ DHE DREJTËSI (PLD)	0.01%	0.19%	0.94%		0.30%	0.56%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË (PSD)	0.01%	0.05%	0.27%		0.00%	0.13%
PARTIA SOCIALISTE 91 (PS 91)	0.00%	0.00%	0.00%		0.00%	0.00%
PARTI TË TJERA	0.03%	0.00%	0.00%		0.00%	0.00%
SHUMA	100.00%	100.00%	100.00%		100.00%	100.00%

3.2.3. Raportet kohore për aktorët “sinkron”

Referuar të dhënave të monitorimit gjatë vitit 2010, në lidhje me “kohën sinkron”, dhënë aktorëve të ndryshëm si përfaqësues të institucioneve ose subjekteve politike, krahasuar midis operatorëve radiotelevizivë, “koha sinkron” paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR EDICIONET INFORMATIVE Koha Sinkron për Aktorët Politikë (koha në %)						
Aktori Politik	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		RADIO TIRANA	TOP ALB. RAD.
Bamir Topi	2.34%	1.81%	3.67%		3.57%	4.19%
Sali Berisha	28.09%	31.23%	17.73%		26.59%	21.27%
Jozefina Topalli	3.54%	2.84%	1.98%		3.78%	2.30%
Edi Rama	5.75%	8.89%	21.18%		12.68%	19.22%
Ilir Meta	5.32%	7.08%	4.98%		6.17%	6.46%
Aktorë të Tjerë	54.96%	48.15%	50.46%		47.20%	46.54%
Shuma	100.00%	100.00%	100.00%		100.00%	100.00%

3.2.4. Raportet kohore për gjininë

Në lidhje me prezencën e aktoreve femra në median elektronike shqiptare, vazhdon të ketë përmirësime nga njëri vit në tjetrin. Vërehet një ndikim më i lartë, nëpërmjet medias elektronike, i gjinisë femërore në politikën shqiptare, e pasqyruar nëpërmjet raporteve kohore (të shprehura në %) vënë në dispozicion të “Aktorit Sinkron”, për secilin nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë.

Po t’i referohemi të dhënave të monitorimit do të vërejmë se “TVSH”, krahasuar me operatorët e tjerë radiotelevizivë, u jep aktoreve femra kohën sinkron më të madhe, me 13.93%. Televizionet “KLAN” dhe Top Channel”, por edhe Top Albania Radio i kushtojnë aktoreve “femra” rreth 10% të kohës sinkron gjatë lajmeve.

TELEVIZIONI SHQIPTAR		
	Minuta	Përqindje
Femër	412	13.93 %
Mashkull	2549	86.7 %

TELEVIZIONI KLAN		
	Minuta	Përqindje
Femër	186	9.88 %
Mashkull	1700	90 %

TOP CHANNEL		
	Minuta	Përqindje
Femër	166	9.64 %
Mashkull	1556	90.36 %

RADIO TIRANA		
--------------	--	--

TOP ALBANIA RADIO		
-------------------	--	--

	Minuta	Përqindje		Minuta	Përqindje
Femër	124	14 %	Femër	41.6	9.8%
Mashkull	766	86 %	Mashkull	382.8	90.2 %

3.2.5. Raportet kohore për temën e lajmit

Në radiotelevizionin publik tema të tilla si “Politika”, “Veprimtaria e Qeverisë” dhe “Problemet Sociale” zënë pjesën më të madhe të kohës gjatë edicioneve kryesore të lajmeve. Koha (e shprehur në %) që vihet në dispozicion të këtyre temave, është rreth 20% secila në TVSH. Problemet e artit dhe kulturës kanë zënë rreth 6.62% të kohës së lajmeve dhe po kaq edhe veprimtaritë e parlamentit. Tema “ekonomia” vjen pas tyre në TVSH me 5.47%.

Në televizionin kombëtar “KLAN, tema që mbizotëron gjatë edicioneve të lajmeve është “politika” me 26.58%. Edhe në televizionin kombëtar Top Channel tema “politika” është e para me 23.42%. Tema e politikës renditet e para edhe në edicionet e lajmeve të transmetuara nga radiot kombëtare, Radio Tirana dhe Top Albania Radio respektivisht me 21.69% dhe 22.15%.

Vërejmë një dukuri negative të transmetuesit kombëtarë, që ka të bëjë me vendin e pakët që zë, në edicionet informative, trajtimi i veprimtarive të qeverisjes vendore. Shifrat në përqindje flasin për 0.26% të TVSH, 0.61% të Klani, 1.24% të TCH, 1.55% të Radio Tirana dhe 1.3% të TAR.

RAPORT I KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR EDICIONET INFORMATIVE Koha e <u>Plotë</u> për Temën e Lajmit (<i>koha në %</i>) Janar - Dhjetor 2010						
TEMA \ OPERATORI	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL		RAD TIRANA	TOP ALB RAD
01.POLITIKA	20.20%	26.58%	23.42%		21.69%	22.15%
02.VEPRIMTARIA E PRESIDENTIT	1.63%	0.50%	0.71%		2.26%	1.04%
03.VEPRIMTARIA E QEVERISË	20.06%	10.66%	4.19%		15.49%	5.81%
04.VEPRIMTARIA E PARLAMENTIT	6.54%	3.90%	3.72%		6.42%	3.47%
05.VEPRIMTARIA E QEVERISË VENDORE	0.26%	0.61%	1.24%		1.55%	1.30%
06.VEPRIMTARIA E DREJTËSISË	0.96%	1.35%	4.07%		1.65%	3.70%
07.SOCIALE	22.09%	18.02%	15.62%		12.91%	12.03%
08.EKONOMI	5.47%	5.65%	6.30%		3.97%	3.13%
09.KRONIKA E ZEZË / RENDI	1.69%	3.79%	3.88%		3.48%	7.01%
10.LAJME NGA KOSOVA / RAJONI	2.22%	4.14%	10.83%		10.71%	13.90%
11.LAJME NDËRKOMBËTARE	2.69%	6.38%	12.60%		11.27%	12.61%
12.ART / KULTURË	6.62%	4.16%	5.93%		3.00%	2.24%
13.SPORT	4.86%	6.26%	4.49%		3.25%	5.90%
14.TË TJERA	4.70%	8.00%	3.00%		2.33%	5.71%
SHUMA	100.00%	100.00%	100.00%		100.00%	100.00%

3.2.6. Dukuri të monitorimit të edicioneve informative

Në procesin e monitorimit të programeve informative jemi gjendur në vazhdimësi përpara një problematike, e cila ka të bëjë me kohën që televizionet dhe radiot kombëtare i kanë **kushtuar institucioneve kryesore qeverisëse dhe kohën kushtuar pasqyrimin të veprimtarive të subjekteve politike.**

Duke iu referuar ligjit nr. 8410, konkretisht nenit 41 të tij "Transmetimit të lajmeve", përcaktohet detyrimi i radiove dhe televizioneve kombëtare për transmetimin e edicioneve informative, si dhe detyrimi për paraqitjen e ngjarjeve në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, që ato të nxisin formimin e lirë të mendimeve dhe të mos i shërbejnë në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie apo organizate politike, grupimi ekonomik dhe komuniteti a shoqate fetare. Por jemi të mendimit se ligji mund të përcaktojë edhe raportet kohore, që duhen respektuar nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë për pasqyrimin e veprimtarive të forcave të ndryshme politike, duke bërë dallimin me veprimtaritë e qeverisë dhe institucioneve të tjera.

Gjithashtu, KKRT bazuar në përvojën evropiane, përsërit sugjerimin që për kohën e plotë dhënë partive të mazhorancës, partive të opozitës, veprimtarive të institucioneve në edicionet informative, të respektohet “rregulli i 3/3” (sipas këtij rregulli, 30% e kohës i kushtohet veprimtarive të partive të mazhorancës, 30% pasqyrimit të veprimtarive të opozitës dhe 30% e kohës veprimtarive të institucioneve. Pjesa tjetër e kohës prej 10% i kushtohet pasqyrimit të veprimtarive politike të partive jashtëparlamentare).

3.3. MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE LIGJORE PËR TRANSMETIMIN E REKLAMAVE

Gjatë monitorimit të reklamave lidhur me zbatueshmërinë e kërkesave ligjore të neneve që përfshihen në Kreun VI “Reklama” dhe të neneve të Kreut VII “Sponsorizimi” është konstatuar se, në përgjithësi, nga të gjithë operatorët radiotelevizivë, bëhen përpjekje për zbatimin e ligjit. Janë respektuar kushte të tilla si kohëzgjatja e transmetimit të reklamave brenda një dite dhe brenda një ore transmetimi, është zbatuar kërkesa e ligjit në lidhje me format e paraqitjes së reklamave dhe kushte të tilla si detyrimi që reklamat të jenë me folës shqip apo të subtitruara në gjuhën shqipe, që ato të jenë të ndershme dhe të mos dëmtojnë të tjerët etj. Janë zbatuar dispozitat ndaluese për reklamat, të përcaktuara në nenin 55 të ligjit. Është për t’u theksuar fakti se, në median tonë elektronike, prej vitesh nuk transmetohen reklamat e produkteve të duhanit dhe asnjë program radioteleviziv nuk është sponsorizuar nga persona fizikë dhe juridikë që kanë si veprimtari kryesore të tyre, tregtimin apo prodhimin e produkteve të duhanit. Duhet vlerësuar fakti se nga operatorët radiotelevizivë janë zbatuar edhe kërkesat e ligjit në lidhje me reklamimin e pijeve alkoolike. Në radio dhe televizion nuk janë vërejtur transmetime reklamash që nxisin sjellje, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal dhe psikik të fëmijëve, që të dëmtojnë interesat dhe veçantitë e moshës së tyre.

Në lidhje me ndërfutjen e reklamave brenda një programi apo një emisioni duhet të pranojmë se ka pasur edhe shkelje, sidomos në rastin e telenovelave dhe filmave artistikë, duke mos u respektuar intervali kohor midis dy ndërprerjeve. Ndryshimet e ligjit sipas rekomandimeve të AVMSD-së në lidhje me kohëzgjatjen e transmetimit të reklamave, përmirësimi kohor në favor të transmetuesve i intervaleve midis dy ndërfutjeve të blloqeve të reklamave etj, mendojmë se do të imponojë një detyrim më të pranueshëm për operatorët televizivë.

Direktiva AVMS përcakton edhe një formë të re të transmetimit të publicitetit, atë të **“vendosjes të produktit”**, e cila edhe pse nuk përfshihet në ligjin tonë aktual, aplikohet në formën e reklamave të fshehta. Me “vendosje të produktit” kuptojmë çdo formë të reklamës apo teleshitjes që konsiston në përfshirjen, referimin ose përmendjen e një produkti, shërbimi ose marke tregtare, që shfaqet brenda një programi, përkundrejt pagesës ose një

shpërblimi të ngjashëm. Në parim “vendosja e produktit” është e ndaluar. Në transmetimet tona televizive ai është përdorur në televizionin “Klan” në emisionin “E Diela Shqiptare”, nga televizioni “Vizion Plus” në emisionin “Zonë e Lirë”, etj. Kjo dukuri po vërehet edhe në disa programe informative dhe emisione të aktualitetit, për të cilat me miratimin e projektligjit “Për transmetimet me zë dhe figurë në RSH”, KKRT do të ndërhyjë për t’i shmangur si forma të paligjshme të transmetimit të reklamave.

Vërejmë se vazhdon përfshirja e reklamave indirekte ose të tërthorta, gjatë transmetimit të edicionit të lajmeve në televizion. Ato janë aplikuar në formën e një kronike duke promovuar një biznes, një shërbim ose një produkt të ri, që bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.

Po ashtu vlen të theksohet se, sipas nenit 54 dhe 54/1 të Ligjit 8410 datë 30.09.1998 “ Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “ Arkivimi i reklamave” ku shprehimisht thuhet, që reklamat e transmetuara ruhen të regjistruara sipas radhës së tyre për një kohë 1-vjeçare nga dita e transmetimit, si dhe për transmetimin e reklamave radiotelevizive, operatorët radiotelevizivë duhet të zotërojnë të drejtën e transmetimit të tyre në Shqipëri, gjë e cila deri më sot nuk është zbatuar.

Në kuadër të përmirësimit të legjislacionit për median elektronike, në propozimet tona për projektligjin e ri është bërë e mundur parashikimi i neneve të veçanta për reklamat e tërthorta, vendosjen e produktit dhe reklamat politike.

3.4. STUDIO E MONITORIMIT

Funksionimi i Studios së Monitorimit në vitin 2010, bazohet në detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, duke kryer monitorimin e programeve në përgjithësi dhe edicioneve të lajmeve në veçanti si dhe monitorimin e reklamave të transmetuara nga ana e operatorëve radiotelevizivë.

Studio e Monitorimit funksionon si një strukturë e dyfishtë:

- A) **Pjesa e parë** e studios është zona e regjistrimit. Për regjistrimin e televizioneve që shihen në qytetin e Tiranës janë në funksion 15 kompjutera regjistruar që, sipas një plani mujor të përcaktuar, regjistrojnë nga ora 11:00 deri në 07:00 të ditës së nesërme, për t’u ristartuar përsëri në 11:00. Mbështetur sa më lart, shprehur në shifra, në Studion e Monitorimit pranë KKRT-së janë regjistruar në total gjatë vitit 2010, rreth 64 800 orë transmetimi televiziv.

Materialet e regjistruara ruhen në 2 servera me kapacitet rreth 950 GB së bashku, si dhe në 3 hard disqe të jashtme me kapacitet rreth 900 GB secili. Pra, në tërësi, kapaciteti ruajtës i studios është rreth 2700 GB , që në terma kohorë është afërsisht 2 muaj informacion i ruajtur në gjendje për t'u përpunuar më tej.

B) **Pjesa e dytë** është zona e monitorimit. Në monitorim funksionojnë 6 poste monitorimi, ku monitoruesit realizojnë detyrat ditore që iu jepen sipas një plani të përcaktuar që në fillim të muajit ose që mund të dalin në sektorë të ndryshëm të institucionit. Në terma statistikorë, në studion e monitorimit, gjatë vitit 2010, janë monitoruar afërsisht rreth 35.000 programe të ndryshme dhe rreth 1800 edicione informative.

Gjatë gjithë periudhës 1 vjeçare është kryer në mënyrë të pandërprerë monitorimi i edicioneve kryesore të lajmeve për Televizionin Publik Shqiptar dhe 2 televizioneve kombëtare, TV Klan dhe Top Channel, si dhe të 2 radiove kombëtare Radio Tiranës dhe Top Albania Radio.

Gjithashtu gjatë gjithë kësaj periudhe është bërë monitorimi i programacionit për televizionet kryesore që shihen në qytetin e Tiranës në lidhje me respektimin e strukturës së tyre programore, për të cilën ata janë licencuar dhe respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të transmetimit.

KKRT, nëpërmjet ekipeve të inspektimit, në periudha të ndryshme gjatë gjithë vitit 2010, ka monitoruar e vëzhguar, përmes sondazheve, programacionin e operatorëve radiotelevizivë vendorë.



IV.RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

Gjatë vitit 2010 KKRT, në përmbushje të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit, për këtë vit, ka vazhduar punën për konsolidimin e veprimtarisë teknike në fushat e:

- 4.1. **Planifikimit të spektrit të frekuencave**, në mbështetje të përmirësimit të mbulimit me sinjal televiziv të operatorëve ekzistues radio e televizivë si dhe në funksion të krijimit të hapësirave të nevojshme për implementimin e rrjeteve të rinj numerikë.
- 4.2. **Monitorimit të shfrytëzimit** të këtij spektri me synim të parandalohen interferencat e dëmshme, dhe
- 4.3. **Identifikimit të transmetimeve të paautorizuara**, duke ndikuar fuqimisht në krijimin e kushteve normale për zhvillimin e misionit dhe biznesit të operatorëve të licencuar.

4.1. PLANIFIKIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

4.1.1. Planifikimi i rrjeteve numerike

KKRT, mbështetur në rezultatet e vitit paraardhës në planifikimin e frekuencave numerike¹, ka vazhduar punën për sigurimin e implementimit të rrjeteve numerike, kombëtare, rajonale e vendore, mbështetur në frekuencat e planifikuara e të regjistruara tashmë në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave.

Siç është raportuar në Raportin për vitin 2009, në datën 20.08.2009 u shkarkuan në WISFAT 354 caktime frekuencore që përfaqësojnë të gjitha frekuencat UHF të parashikuara në Planin GE06 për Shqipërinë. Regjistrimi përbën një mbrojtje nga kontestimet e vendeve fqinjë. Në fakt, gjatë vitit të kaluar, administrata italiane, ka kontestuar zyrtarisht pranë ITU disa nga caktimet frekuencore shqiptare të regjistruara rregullisht në sistemin WISFAT (Web Interface for Submission of Frequency Assignments/allotments (terrestrial Services) - Ndërfaqja web për parashtrimin e Caktimeve/Allotmenteve Frekuencore (Shërbimet tokësore)². ITU (Byroja e Radiokomunikacioneve), në përgjigjen dërguar administratës italiane thekson se këto caktime janë regjistruar rregullisht në Regjistrin ndërkombëtar të frekuencave në emër të administratës shqiptare. Sidoqoftë, marrëveshja GE 06

¹ Shih Raportin Vjetor për vitin 2009, pika 4.1 **Planifikimi i rrjeteve numerike**

² Po aty

“Për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të Rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470- 852 MHz” përcakton zhvillimin e bisedimeve midis administratave gjatë procesit të vënies në punë të caktimeve frekuencore numerike. Gjatë vitit të kaluar, nga pala italiane janë kërkuar bisedime për të diskutuar mbi vënien në punë të caktimeve frekuencore të kontestuar nga kjo administratë, si dhe për të modifikuar planin numerik në zbatim të marrëveshjes Francë-Itali, siç shpjegohet më poshtë.

Në 7 prill 2010, Franca dhe Italia nënshkruan një Marrëveshje, e cila përfshin modifikimin e planit GE 06 ekzistues. Këto modifikime parashikojnë ndryshime dhe shtesa kanalesh midis Italisë dhe Francës në disa zona, siç ilustron nga tabela e mëposhtme (Tab 1).

Allotmenti ose zona gjeografike	Plani GE-06 aktual		Plani GE-06 i modifikuar			
Alpes M. Est	Recorded CH58		MOD 58 in 29	ADD 43	ADD 39	
Alpes M. Ouest	Recorded CH58		MOD 58 in 29	ADD 43	ADD 39	
Corse			ADD 29	ADD 43		
Liguria	Recorded CH29		MOD 29 in 58	ADD 55	ADD 47	
Toscana	Recorded CH43		MOD 43 in 58	ADD 55	ADD 47	
Lazio			ADD 58		ADD 47	
Sardinia	Recorded CH47		ADD 58	ADD 55		

Tab. 1. Caktimet frekuencore të përcaktuara nga marrëveshja Francë-Itali që duhen miratuar nga KKRT

Bazuar në Nenin 4 të Marrëveshjes GE06 Administrata shqiptare afektohet nga një apo disa nga modifikimet e mësipërme.

KKRT ra dakord për zhvillimin e bisedimeve me palën italiane, por për arsye të ndryshme takimi është shtyrë disa herë, gjë që ka penguar miratimin e regjistrimit të këtyre caktimeve frekuencore në MIFR³.

Më poshtë jepet shtrirja gjeografike e shtesave dhe modifikimeve si rezultat i marrëveshjes Francë-Itali (shënuar me ngjyrë të kuqe) :

³ Regjistri Kryesor Ndërkombëtar i Frekuencave që mbahet nga ITU.




Fig. 1. Caktimet frekuencore të përcaktuara nga marrëveshja Francë-Itali që duhen miratuar nga KKRT

Siç shihet të gjitha caktimet frekuencore të përcaktuara nga marrëveshja Francë-Itali nuk ndodhen përballë brigjeve shqiptare, për pasojë, për shkak të kurbësisë së Tokës, pengesave të reliefit (maleve), ERP⁴-së më të ulët të transmetimeve numerike kundrejt atyre analoge, nuk pritet që këto caktime shtesë të ndikojnë duke krijuar interferenca në planin numerik shqiptar.

Bisedimet me palën italiane do të zhvillohen gjatë vitit 2011. Në to do të synohet të merret miratimi i administratës italiane edhe për disa modifikime e shtesa në planin shqiptar të frekuencave numerike, që do të shërbejnë qoftë për lirim të brezit 790-862 MHz (dividendi numerik⁵), qoftë për rritjen e numrit të mbulimeve numerike lokale, duke synuar deri në krijimin e një mbulimi shtesë kombëtar.

4.1.2. Shfrytëzimi i dividendit digital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.

Në Evropë, kalimi nga transmetimet analoge në transmetimet numerike tokësore në fund të 2012 do të lirojë një sasi spektri të konsiderueshëm si rezultat i efikasitetit më të madh të teknologjisë numerike. Ky spektër njihet si “dividendi numerik”.

⁴ ERP- Fuqia Efektive e Rrezatuar (Effective Radiated Power)

⁵ Shih 4.1.2 më poshtë

Dividendi numerik konsiderohet si një mundësi unike për të plotësuar kërkesën në rritje të shpejtë për shërbimet e komunikimit pa tel. Ai hap një spektër të mjaftueshëm për transmetuesit për të zgjeruar e zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme shërbimet e tyre, duke siguruar në të njëjtën kohë përdorime të tjera të rëndësishme sociale e ekonomike, si aplikimet me bandë të gjerë.

Në Shqipëri, në brezin e parashikuar për Dividendin Numerik (Digital), aktualisht ka transmetime analoge, transmetime ekzistuese numerike dhe kanale të planifikuara për transmetime numerike sipas Planit GE 06. Problem kryesor rezulton riplanifikimi i transmetimeve numerike në breza më të ulët frekuencash, për të mos pakësuar kapacitetet transmetuese të fituara nga Plani GE 06. Për këtë qëllim duhet planifikuar koordinimi me vendet fqinjë dhe duhet bërë regjistrimi në GE 06 të rreth 13 % të caktimeve frekuencore totale të planifikuara nga GE 06. Vetëm pasi të jetë realizuar migrimi i këtyre caktimeve frekuencore në breza frekuencash më të ulëta (470 – 790 MHz), mund të fillojë përdorimi i brezit të DD (790 – 862 MHz) për aplikime me bandë të gjerë, me leverdi për ekonominë. Prandaj sa më parë të realizohet kalimi i plotë në transmetimet numerike dhe të bëhet riplanifikimi në breza më të ulëta, aq më parë lirohet spektri i DD.

4.1.3. Planifikimi i rrjeteve analoge

Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv), për licencimin e operatorëve të rinj, dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.

Në përmbushje të detyrave për vitin 2010, KKRT, ka organizuar studimin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave si për TV dhe radio FM, për përcaktimin e frekuencave të lira për shpalljen e konkurrimit të kandidaturave, në përgjigje të kërkesave nga zona të ndryshme të vendit. Për këtë janë bërë llogaritje për mbulimin e zonave të licencimit si dhe llogaritje për eliminimin e interferencave me sinjalet e tjera radio dhe televizive.

Pas llogaritjeve në tavolinë është dashur kryerja e matjeve në vend për shfrytëzimin e spektrit dhe zhurmat e ndryshme, konsultimi me data base-t e ITU-s për transmetimet në vendet fqinjë etj. Nga kontrollet dhe matjet është konstatuar se shfrytëzimi i spektrit në Shqipëri vazhdon të rëndohet, sidomos në zonat me interes të lartë (ultësira perëndimore deri në Sarandë, Zona e Korçës, etj) ndërsa nuk ka interes për mbulimin e zonave të largëta (Peshkopi, B. Curri, Ersekë).

Gjithsej, gjatë vitit 2010, është përgatitur dokumentacioni teknik për 2 caktime frekuencore për transmetime televizive vendore private dhe 16 caktime

frekuencore për transmetime vendore private radio FM (shih tabelat Tab.2 dhe Tab.3 më poshtë).

Pas zbatimit të procedurave të garave, gjatë vitit 2010, janë licencuar **(2)** operatorë të rinj vendorë privatë televizivë: TV RE.AL (1 caktim frekuencor) dhe TV Star Plus (1 caktim frekuencor).

Gjithashtu janë licencuar **(4)** operatorë vendorë privatë radio. Tre prej tyre me **(3)** caktime frekuencore dhe një me **(2)** caktime frekuencore.

Është zgjeruar zona e licencimit për 2 operatorë vendorë radio:

- Radio Eagle (ish Dinamic Sound B-94) nga rrethet Tiranë-Durrës aktualisht, ju janë shtuan **(6)** caktime frekuencore për mbulimin me sinjal të Qarkut Fier dhe Qarkut Vlorë.
- Radio Energy nga rrethet Tiranë-Durrës dhe rrethi Elbasan aktualisht, iu shtuan **(5)** caktime frekuencore për mbulimin me sinjal të Qarkut Fier dhe Qarkut Vlorë.

Gjatë vitit 2010 është përgatitur dokumentacioni teknik për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për licencimin e operatorëve të rinj televizivë.

Bazuar në Ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998 “ Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Neni 34, pika 4) *operatori duhet të fillojë transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe 180 ditë në transmetimet e radio vendore dhe 270 ditë në transmetimet e televizionit vendor.*

Në tabelat e mëposhtme (Tab. 2, Tab. 3. dhe Tab. 4.) janë paraqitur operatorët e licencuar në vitin 2010 dhe gjendja e tyre faktike e transmetimit.

Nr	Emri	Pika e transmetimit	Data e licencimit	Afati i fundit daljes në transmetim	Zona e licencimit	Gjendja reale e transmetuesit
1	TV RE.AL	Zvërnec	22.12.2010	20.09.2011	Qyteti Vlorë	Në transmetim
2	TV STAR PLUS	Tarabosh	22.12.2010	20.09.2011	Rrethi Shkodër	(Brenda afatit ligjor)

Tab. 2. Operatorë të rinj të licencuar për TV vendorë

Nr	Emri	Pika e transmet.	Data e licencimit	Afati fundit daljes në transmetim	Zona e licencimit	Gjendja reale e transmetuesit
1	Radio GRET A MUSIC RADIO	Tiranë Qytet	09.09.2010	06.03.2011	Qyteti Tiranë	Në Transmetim
2	Radio ONE	Fushë-Dajt	09.09.2010	06.03.2011	Rrethet Tiranë-Durrës	Në Transmetim
3	Radio GRANT	Tarabosh	09.09.2010	06.03.2011	Rrethi Shkodër	(Brenda afatit ligjor)

Tab.3 Operatorë të rinj të licencuar për radio FM 3

Nr	Emri	Pikat e transmet. egzistues	Data e vendimit për zgjerim zone	Pikat e reja të transmetimit	Zgjerimi i zonës së mbulimit	Gjendja reale e transmetuesve në pikat e reja
1	Radio ENERGY	Fushë-Dajt Petresh	28.07.2010	Zvërnec, Llogara, Treblovë, Mile, Ardenicë	Qarku Fier, Qarku Vlorë	Transmeton vetëm në Ardenicë dhe Zvërnec
2	Radio EAGLE	Fushë-Dajt	20.12.2010	Zvërnec, Llogara, Treblovë, Mile, Fier (qytet) Lushnjë (Blerim)	Qarku Fier, Qarku Vlorë	(Brenda afatit ligjor)

Tab. 4. Operatorë Radio FM të licencuar për zgjerim të zonës së mbulimit

Në vitin 2010 është përgatitur Lidhja III dhe Lidhja IV e dokumentit të licencës⁶ për 29 operatorë radioteleviziv, nga të cilët 13 operatorë radio vendore, 2 operatorë televizivë vendorë dhe 14 televizione kabllorë të licencuar gjatë vitit 2009-2010.

⁶ Lidhja II dhe lidhja IV e dokumentit të licencës janë specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese.

4.2. MONITORIMI I SHFRYTËZIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

Bazuar në eksperiencën e fituar në vite, edhe gjatë vitit 2010, KKRT ka ndjekur transmetimet radio e televizive, me qëllim identifikimin e lokalizimin e transmetimeve të paautorizuara dhe në raste shkeljesh, marrjen e sanksioneve dhe ekzekutimin e tyre ndaj operatorëve të ndryshëm.

Krahas inspektimit të planifikuar, për sinjalet radio e televizive që mund të kapen nga Tirana (kryesisht për sinjalet që mbulojnë hapësirën Tiranë-Durrës), është organizuar monitorimi ditor, që regjistron gjendjen e transmetimeve radiotelevizive, e cila raportohet në fund të çdo jave.

Evidentimi i saktë dhe ndjekja e përditshme ka bërë që të mbahet nën kontroll regjimi i transmetimeve, sidomos në zonën e rënduar Tiranë-Durrës, ku me të konstatuar një anomali, është ndërhyrë menjëherë për të stabilizuar situatën.

4.2.1. Operatorë radio e televizivë privatë vendorë të transmetimeve analoge tokësore dhe televizione kabllorë që u është hequr licenca se kanë ndërprerë transmetimet apo nuk kanë dalë në transmetim mbas licencimit

Nga inspektimet e kryera në terren janë konstatuar **(5)** operatorë nga të cilët (1) radio vendore, (3) televizione vendorë dhe (1) televizion kabllor të cilët kanë shkelur ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 34, për arsyet si më poshtë:

1. TV "Dibra Vizion " në Peshkopi
2. TV "Kuçova " në Kuçovë

kanë fikur transmetuesit e tyre për 30 ditë *gjatë një viti kalendarik* (ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 34 pika 5)

3. TV "Scutari "

Ky operator ishte i autorizuar të mbulojë me sinjal televiziv analog rrethin Shkodër.

Nga inspektimet e kryera në këtë qytet ka rezultuar se, për periudhën 4 vjeçare, 2007-2010, operatori televiziv privat vendor nuk ka filluar transmetimin për të mbuluar me sinjal zonën e tij të licencimit dhe nuk ka paraqitur pranë KKRT-së asnjë arsye për justifikimin e këtij veprimi.

4. Radio "City"

Ky operator i licencuar me vendim nr. 742, dt. 07.11.2008 është autorizuar të mbulojë me sinjal rrethet Tiranë-Durrës. Nga inspektimet e kryera në Tiranë ka rezultuar se për periudhën 21 mujore, nëntor 2008 – korrik 2010, subjekti ka shkelur detyrimin ligjor për të filluar transmetimin brenda 180 ditësh pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence (ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 34, pika 4/a).

5. TV kabllor “Cable Tel”

Ky operator ka si zonë licencimi qytetin e Tiranës.

Nga inspektimet e kryera në Tiranë ka rezultuar se për periudhën 13 mujore maj 2009 - qershor 2010, subjekti ka shkelur detyrimin ligjor për të filluar transmetimin brenda 270 ditëve pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence (ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 34, pika 4/a)

Për këta (5) operatorë radio e televizivë KKRT ka vendosur masën e heqjes së licencës.

4.2.2. Operatorë radiofonikë privatë vendorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.

Nga monitorimi në terren apo monitorimi ditor i kryer nga qendra fikse e monitorimit të frekuencave në KKRT, në periudha të ndryshme të vitit 2010, janë gjetur të fikur stacionet transmetues të disa operatorëve radiofonikë kombëtarë e vendorë, si më poshtë:

Radio kombëtare “Radio + 2” - Tiranë

Është monitoruar në data të caktuara gjatë vitit 2010 dhe nuk është gjetur në transmetim, në disa pikat transmetuese si: Çervenakë (dt. 2.08.2010), Zvërnec (dt 28.01.2010, dhe 10.08.2010), Ardenicë (dt. 10.08.2010 dhe 31. 08.2010).

Radio vendore “Eagle” - Tiranë

Për periudhën prill - maj 2010, transmetimi i programeve të këtij subjekti ka pasur ndërprerje të shpeshta. Transmetuesi i vendosur në pikën Fushë-Dajt ka qenë i fikur 10 ditë në muajin prill dhe 18 ditë në muajin maj.

Radio vendore “ROCK” - Tiranë

Për periudhën tre mujore janar - mars 2010, transmetimi i programeve të këtij subjekti ka pasur ndërprerje të shpeshta. Transmetuesi i vendosur në pikën Fushë-Dajt ka qenë i fikur 3 ditë në muajin janar, 19 ditë në muajin shkurt dhe 10 ditë në muajin mars.

Radio vendore “IME” -Tiranë

Për periudhën tre mujore janar - mars 2010, transmetimi i programeve të këtij subjekti ka pasur ndërprerje të shpeshta. Transmetuesi i vendosur në pikën

Fushë-Dajt ka qenë i fikur 10 ditë në muajin janar, 10 ditë në muajin shkurt dhe 18 ditë në muajin mars.

Sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, neni 34 pika 5: «Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur ... 5. pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës».

Kur ka konstatuar ndërprerje të gjata, KKRT, para plotësimit të afatit kohor prej 30 ditësh, me shkresa të veçanta, i ka njoftuar subjektet për sanksionin e parashikuar në ligj duke kërkuar informacion mbi arsyet e ndërprerjes së transmetimeve.

Subjektet kanë paraqitur në KKRT arsyet e tyre të ndërprerjes së transmetimeve dhe më pas kanë filluar të transmetojnë.

4.3. TRANSMETIME TË PALICENCUARA (SHFRYTËZIM I PAAUTORIZUAR I SPEKTRIT)

4.3.1. Transmetimet e "Vizion+"

Siç është raportuar edhe në vitin 2009, licenca si operator televiziv vendor për subjektin "TV Vizion+" është bërë e pavlefshme pas kërkesës së vetë subjektit.

Me marrjen e licencës satelitore subjekti ka depozituar kërkesën për të ritransmetuar programin e tij edhe në rrugë tokësore, por KKRT nuk është shprehur për këtë kërkesë. **Aktualisht subjekti "TV Vizion+" transmeton në të gjithë zonën ku më parë ka operuar si operator vendor.**

4.3.2. Transmetimet e Klan TV

Në përpjekje për zgjidhjen e problemit të ndryshimit të kanalit të transmetimit në pikën e Malit të Dajtit⁷ TV "KLAN" kërkoi nga KKRT:

1. **ndryshimin e caktimit frekuencor në pikën e transmetimit të malit të Dajtit**, nga kanali 28 UHF në kanalin 30 UHF, për shkak të ndërhyrjeve të forta nga kanali HRT 2 dhe
2. **përdorimin e përkohshëm të kanalit 41 UHF nga pika e malit të Dajtit (1613 m) për mbulimin e zonave prapa malit të Dajtit.**

Duke qenë se:

⁷ Shih "Raporti i Vitit 2009"

1. kanali 30 ka qenë në përdorim dhe është provuar që nuk shkakton interferencë të dëmshme në kanalet e tjera, si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Republikës; dhe
2. ky kanal konsiderohet i pranuar edhe nga Marrëveshja GE 06, pasi ka qenë në përdorim para se të nënshkruhej GE 06.

Kërkesa 1, e mësipërme, u pranua nga KKRT me vendimin nr 234, të datës 20.12.2010. Njëkohësisht me vendim nr. 236, të datës 20.12.2010 nuk u pranua kërkesa 2 për përdorim të përkohshëm të kanalit 41, pasi po punohet për zgjidhjen e kësaj situate komplekse.

4.3.3. Transmetimet TV ABC News

Operatori TV ABC News (Operator vendor i transmetimeve analoge tokësore) paraqiti në KKRT kërkesë për ndryshim të caktimit frekuencor nga Ch 41 UHF në Ch 28 UHF.

Duke qenë se kërkesa për të realizuar këtë ndryshim është shprehje e dëshirës së operatorit për të transmetuar në frekuenca të ulëta që konsiderohen më të përshtatshme, kërkesa u pranua nga KKRT me vendimin nr 235, të datës 20.12.2010, por ky operator transmeton pa autorizimin e KKRT-së, nga pikat transmetuese Tarabosh në Ch 34 UHF dhe Korçë në CH 23 UHF.

4.3.4. Operatori televiziv vendor TV JUG

Ky operator ka ndryshuar pa autorizimin e KKRT-së pikën e transmetimit nga qendra e qytetit Fier në pikën transmetuese Ardenicë.

Grupi i inspektimit ka ndëshkuar këtë subjekt me gjobë dhe KKRT po ndërmeret masa për rregullimin e gjendjes.

4.3.5. Transmetim sinjali televiziv analog i palicencuar

Në qytetin Vau-Dejës nga matjet e shfrytëzimit të spektrit, është identifikuar sinjal televiziv analog në kanal 46 të brezit UHF.

KKRT, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve të Rrethit Shkodër, kryen bllokimin e pajisjeve transmetuese të këtij subjekti të palicencuar.

4.3.6. Rritje e paautorizuar e fuqisë së transmetimit

KKRT konstaton se, edhe këtë vit, rritja e paautorizuar e fuqisë së transmetimit nga pothuaj të gjithë operatorët që kanë instaluar stacione transmetues në malin e Dajtit, ka shkaktuar herë pas here interferenca, sidomos midis kanaleve fqinjë.

Me ndërhyrjet e saj, KKRT është përpjekur t'i mbajë interferencat në nivel minimal. Ndërhyrjet janë realizuar në formën e paralajmërimeve dhe, kur këto të fundit nuk kanë dhënë rezultat, janë ndërmarrë sanksionet e parashikuara në ligjin nr. 8410, datë 30. 09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë".

Për vitin 2010 KKRT, me blerjen e aparatit për matjen e ERP-së, është në gjendje të regjistrojë dhe të evidentojë vlerat e sakta të fuqisë efektive të rrezatuar nga çdo transmetues.

4.3.6.1. Transmetimet e TV Elrodi Music, Vorë

Ky operator është licencuar si subjekt televiziv privat vendor, për transmetime televizive analoge tokësore, me zonë licencimi Bashkinë Vorë. Ky subjekt ka kërkuar të zgjerojë zonën e mbulimit edhe në qytetin e Tiranës. Çështja është diskutuar në disa mbledhje të KKRT-së dhe për mungesë frekuencash për mbulimin me sinjal televiziv të qytetit Tiranë, zonë e mbingarkuar, subjektit i është dhënë përgjigje negative.

Me gjithë përgjigjet negative të KKRT-së, subjekti Elrodi Music ka ngritur fuqinë e transmetimit në mënyrë të paautorizuar, duke bërë që sinjali i tij të mbulojë edhe Tiranën. Grupi i inspektimit, pas shumë paralajmërimesh, e ka ndëshkuar këtë subjekt me gjobë. Pas kësaj mbledhjeje, subjektit iu kërkua të reduktojë fuqinë e transmetimit dhe të ndryshojë drejtimin e antenave me qëllim të ulët niveli i sinjalit në drejtim të Tiranës.

4.3.7. Rrjete kabllore të palicencuar

Nga inspektimet në terren është konstatuar një numër operatorësh kabllorë kryesisht në komuna e fshatra të veçuar (zona e Fierit, Berati, Vlorë, Korçë dhe Sarandë (Ksamil)) që operojnë pa licencë të lëshuar nga KKRT. Për këta operatorë televiziv të palicencuar, janë mbajtur proces-verbale për bllokimin apo sekuestrimin e pajisjeve të tyre. Mbështetur në këto proces-verbale KKRT ka marrë vendime të cilat i janë përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për ekzekutim.

4.3.8. Transmetime numerike të paautorizuara në kanalet e licencuara si analoge

KKRT ka autorizuar “Tring” TV për transmetime numerike tokësore në kanal 59 UHF⁸.

“Tring” vazhdon të transmetojë edhe në kanal 47 UHF (pa autorizim të KKRT), i cili është licencuar nga KKRT për transmetimin e programeve analoge tokësore të subjektit TV Dardan. Ky kanal nuk bën pjesë në Planin e frekuencave numerike të Shqipërisë.

KKRT ka nisur hetimin administrativ për zgjidhjen e kësaj situate.

4.3.9. Transmetimet numerike të paautorizuara

Nga monitorimi i spektrit në Tiranë janë konstatuar **transmetime numerike në kanal 53 UHF**. Nga inspektimi në pikën e Malit të Dajtit, u përcaktua vend ndodhja e stacionit transmetues të palicencuar. KKRT mori masa për mbylljen e tij. Aktualisht këto transmetime janë ndërprerë.

Po kështu, janë konstatuar transmetime numerike të palicencuara, në qytetin e Peshkopisë (**kanali 28 UHF**).

Pas identifikimit të autorit, KKRT, në bashkëpunim me policinë tatimore, ka marrë masat për mbylljen e transmetimeve numerike të paautorizuara duke lëshuar urdhrin përkatës, por siç kemi përmendur edhe më parë në këtë Raport, bashkëpunimi me Drejtoritë Tatimore, sidomos në rastet kur kërkohet ndërhyrje energjike për mbyllje transmetimesh pa leje apo sekuestre, nuk është në nivelin e parashikuar nga aktet normative në fuqi.

4.4. OPERATORËT

4.4.1. Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge

4.4.1.1. Televizioni publik

Gjatë vitit 2010, TVSH ka vazhduar transmetimin, në pikën transmetuese të malit të Dajtit, e programeve të mbështetura në teknikën analoge në kanalet Ch 57 - TVSH1 dhe Ch 40 - TVSH2.

- Në zbatim të planit për lirim të frekuencave numerike të hartuar nga KKRT, TVSH1 duhet të ndryshojë kanal 57 UHF në

⁸ Shih 4.4.2.2

pikën transmetuese të malit të Dajtit, pasi ky kanal është i planifikuar për transmetime numerike.

- Rrjeti i dytë TVSH2 mbulon vetëm zonën Tiranë-Durrës, ndërsa "... duhet të mbulojë territorin e banuar nga të paktën 90% e shtetasve të Republikës së Shqipërisë" (nenet 70 dhe 71 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar).

Ndërtimi i rrjetit të dytë analog për RTSH, megjithëse i diktuar nga ligji nr. 8410, konsiderohet si joefektiv në kushtet e kalimit iminent në transmetimet numerike (viti 2012).

Sipas ligjit nr. 8410, i ndryshuar, të gjitha frekuencat që janë në përdorim të RTSH-së, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten në dispozicion të këtij institucioni për një periudhë 10-vjeçare. Në ligj nuk ekzistojnë indikacione të tjera për rregullimin e mëtejshëm. Gjatë periudhave të mëparshme, me kërkesë të RTSH-së, KKRT ka autorizuar përdorimin e frekuencave në pika të ndryshme. Por ekziston edhe një praktikë, kur RTSH ka instaluar stacione transmetues në pika të ndryshme pa marrë autorizimin e KKRT-së, duke shkaktuar në disa raste edhe interferencë në transmetimet e operatorëve të licencuar, për të cilët KKRT ka detyrimin t'i mbrojë nga interferencat. Stacioni i TVSH-së, i instaluar pa autorizimin e KKRT në pikën e Ardenicës, vazhdon të krijojë interferenca në sinjalin e operatorit lokal TV Klaudiana (Peqin, Ch 24).

KKRT po bashkëpunon me RTSH-në për zgjidhjen përfundimtare të transmetimeve të paautorizuara, nëpërmjet ristudimit të mbulimit me sinjal të RTSH të territorit të vendit, i cili do të miratohet bashkërisht nga KKRT dhe RTSH.

Figurat e mëposhtme (Fig. 5 dhe 6) pasqyrojnë mbulimin e territorit shqiptar me sinjalin e TVSH-së.




Fig. 5 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën VHF, i realizuar nga TVSH




Fig. 6 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën UHF, i realizuar nga TVSH

4.4.1.2. Operatorët privatë kombëtarë

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre.

Vitet	Emërtimi	TVS H	Radio Tiran	TVA	TV Klan	R.T. Alb	Radio +2	TV Top Channel
		Publik	Publik	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2002	Viti lic. 2008
2002	Viti i lic. apo rilic.	---	---	2	2	2	----	----
	Kushtet e licencës	---	---	7.33	7.33	28.85	----	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	27.39	40.91	87.22	-----	----
2003	Viti i lic. apo rilic.	---	-----	3	3	3	1	----
	Kushtet e licencës	---	-----	26.4	26.4	55.76	10.11	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2004	Viti i lic. apo rilic.	---	-----	4	4	4	2	
	Kushtet e licencës	---	-----	46.97	46.97	72.69	28.87	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2005	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	5	5	5	3	
	Kushtet e licencës	----	-----	62.09	62.09	94.4	55.76	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	30.1	42.68	87.22	72.64	----
2006	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	6	6	6	4	

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

	Kushtet e licencës	----	-----	75.71	75.71	90	72.68	-----
	Mbulim i faktik %	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	-----
2007	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	7	7	0	5	-----
	Kushtet e licencës	----	-----	86.86	86.86	90	94.4	-----
	Mbulim i faktik %	73.31	80.54	30.1	44.53	87.22	72.64	-----
2008	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	8	8	1	0	1
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	90	50
	Mbulim i faktik %	73.31	80.54	40.8	69.8	87.22	72.64	62.1
2009	Viti i lic. apo rilic.		----	8	1	2	1	2
	Kushtet e licencës	----	-----	-----	90	90	90	50
	Mbulim i faktik %	73.31	80.54	-----	70.2	87.22	72.64	62.1
2010	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	Lic.e pavle fshme	2	3	2	3
	Kushtet e licencës	-----	-----	90	90	90	90	90
	Mbulim i faktik %	73.31	80.54	-----	70.2	87.22	72.64	62.1

Tab.3 Zgjerimi i mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizivë

Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB ($\mu\text{V}/\text{m}$) për sinjalin TV dhe nivelin 50 dB ($\mu\text{V}/\text{m}$) për sinjalin radio.

4.4.1.2.1. Operatori Kombëtar TVA

Edhe gjatë vitit 2010, KKRT ka konstatuar se subjekti televiziv privat kombëtar "TV Arbëria", për një periudhë kohe gati dyvjeçare, nuk ka përmbushur kërkesat ligjore për transmetimin e sinjalit.

Konkretisht, nga inspektimet teknike të kryera në territorin e Republikës ka rezultuar se transmetuesit e saj të vendosur në pikat kryesore transmetuese kanë qenë të fikura.

KKRT me Vendim nr. 186 të datës 22.10.2010, ka bërë të pavlefshme licencën me nr. 02/TVK të subjektit televiziv privat kombëtar "TV Arbëria".

4.4.1.2.2. Operatori Kombëtar TV KLAN

Operatori Kombëtar TV KLAN mbulon rreth 70 % të territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal të vazhdueshëm e me cilësi. Gjatë vitit 2010 është instaluar një numër përsëritësish të rinj në pikat sekondare të rrjetit. Megjithatë KLAN TV nuk e ka arritur akoma nivelin e mbulimit të përcaktuar në kushtet e licencës.

TV Klan transmeton nga studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.




Fig.7 Pikat e transmetimit të TV KLAN






Fig.10 Mbulimi me sinjal analog tokësor i TV TOP CHANNEL

4.4.1.3. Operatorët privatë vendorë

Peizazhi audiovizual në Shqipëri u plotësua me operatorë të rinj radio (FM) dhe televizivë tokësorë të teknologjisë analoge. Këto shtesa kanë sjellë rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të frekuencave, gjë që ka krijuar vlera të reja, monetare dhe kulturore sidomos në favor të komuniteteve lokale.

Gjatë vitit 2010 nuk ka pasur operatorë që kanë investuar për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së tyre të licencimit, por ka pasur nga ata, operatorë radio, që e kanë zgjeruar aktivitetin në zona të reja me vazhdimësi gjeografike si më poshtë:

- Radio Energy ka zgjeruar zonën e mbulimit në 2 qarqe, Fier dhe Vlorë (5 caktime frekuencore).
- Radio Eagle ka zgjeruar zonën e mbulimit në 2 qarqe Fier dhe Vlorë (6 caktime frekuencore).

Operatorë televizivë që rezultojnë me mbulim më të ulët të zonës së licencimit vazhdojnë të jenë:

- TV Gramshi 7.2 %
- TV Berati Nga 6.2 % vitin e kaluar në 14.72 % në vitin 2009

Operatorët që mbulojnë deri në 70 %:

- Tirana TV 42.53 %
- Supersonic 61.24 %

Televizione me mbulim të mirë:

- UFO (ish Teuta TV) 78.32 %
- si dhe disa TV të vogla, (TV 4+, Klaudiana, etj)

Në transmetimet radiofonike, situata paraqitet e pandryshuar, me përjashtim të licencimit të disa operatorëve të rinj.

4.4.2. Transmetimet numerike ekzistuese

4.4.2.1. Digitalb

Operatori Digitalb ka filluar transmetimet prej korrikut 2004 pa licencën e KKRT-së. Ky operator ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore (4 rrjete fikse dhe 1 mobil).

Në muajin dhjetor 2010, ky operator ka zgjeruar zonën e mbulimit duke vendosur stacion transmetues të instaluar në pikën transmetuese Çardhak, pa

autorizimin e KKRT-së, ndaj KKRT po punon për zgjidhjen përfundimtare të kësaj situate.

Digitalb i licencuar si operator numerik satelitor ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore.




Fig. 11 Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik të DigitAlb




Fig. 12. Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik DVB-H (mobil) të DigitAlb (kufijtë me viza të kuqe janë për ish zonën e mbulimit)

4.4.2.2. Tring

Në sistemin numerik tokësor TRING ka ndërtuar dy rrjete fikse për të cilat përdor dy kanale UHF (*Ultra High Frequency*), (Kanalin 59 dhe kanalën 47), nëpërmjet stacioneve transmetues të instaluar në malin e Dajtit duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës.

Leja e përkohshme “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” e lëshuar nga KKRT më 23.01.2008 për TV Vizion+, përcakton përdorimin e kanalit 59, nëpërmjet një stacioni transmetues të instaluar në malin e Dajtit. Kjo leje e përkohshme përcakton edhe kushtin që në mbarim të afatit të përcaktuar në të, operatori duhet të paraqesë në KKRT një informacion të hollësishëm mbi rezultatet tekniko-ekonomike të eksperimentimit dhe konkluzionet përkatëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar nga TRING, megjithëse afati i lejes së përkohshme ka përfunduar në datën 24.07.2008.

TRING tashmë është licencuar si operator numerik satelitor. Në këtë sistem ai ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore.




Fig. 13. Mbulimi me sinjal nga televizioni numerik tokësor TRING

4.4.2.3. Shijak TV

Në sistemin numerik tokësor Shijak TV ka ndërtuar një rrjet fiks, për të cilin përdor 1 kanal UHF nëpërmjet një stacioni transmetues të instaluar në malin e Dajtit, duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës. Aktualisht për transmetimin numerik, Shijak TV përdor kanalën 24 UHF, ndërsa Leja e përkohshme “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” e lëshuar nga KKRT, përcakton përdorimin e kanalit 44, nëpërmjet stacioneve transmetues të instaluar në qytetin e Tiranës. Leja e përkohshme përcakton edhe kushtin që, në mbarim të afatit të përcaktuar nga kjo leje, operatori duhet të paraqesë në KKRT një informacion të hollësishëm mbi rezultatet tekniko-ekonomike të

eksperimentimit dhe konkluzionet përkatëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar nga Shijak TV, por nga të dhënat që disponon KKRT, rezulton se eksperimenti nuk ka arritur rezultatet e synuara tekniko-ekonomike.




Fig. 14 Mbulimi me sinjal nga televizioni numerik tokësor Shijak

Konkluzion

Situata e transmetimeve numerike tokësore vazhdon të jetë krejtësisht e parregulluar, për pasojë e pakontrolluar. Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, operojnë pa licenca përkatëse ku përcaktohen rregullat dhe kushtet e shërbimit, si dhe detyrimet përkatëse financiare duke shtrembëruar tregun në dëm të operatorëve analogë të licencuar rregullisht.

Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, përfshirë operatorët me shtrirje të konsiderueshme në territorin e Shqipërisë, si Digitalb-i, realisht janë

faktorë përcaktues për transmetimin numerik në Shqipëri, ndaj në projektstrategjinë e hartuar për kalimin nga transmetimet analoge në ato dixhitale, është synuar t'i jepet zgjidhje edhe kësaj situatë.

4.4.2.4. Transmetime numerike të palicencuara, të konstatuara në vitin 2010

Gjatë vitit 2010, nga monitorimi në terren, KKRT ka konstatuar:

1. Transmetime numerike të pa autorizuar në kanalet 21 dhe 66 të brezit UHF. Në bazë të këtij informacioni KKRT inspektoi pikën e transmetimit në Malin e Dajtit, përcaktoi vendndodhjen e stacionit transmetues të pa licencuar, si dhe identifikoi operatorin TV ALSAT që kryente këto transmetime. Aktualisht këto transmetime nuk janë ndërprerë dhe KKRT po punon për zgjidhjen e kësaj çështjeje.
2. Transmetime numerike në qytetin e Sarandës në kanalet 24, 32 dhe 46 të brezit UHF, pa autorizimin e KKRT-së. KKRT ka lëshuar Urdhrin e bllokimit të pajisjeve (Urdhri nr. 229, datë 14.09.2010 "Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Dixhital Numerik Tokësor, Saranda, të palicencuar në qytetin e Sarandës"), i cili nuk është ekzekutuar ende nga Drejtoria e Tatimeve.
3. Transmetime numerike në qytetin e Peshkopisë në kanalet 40, 43, 44 dhe 47 të brezit UHF, pa autorizimin e KKRT-së.
4. Transmetime numerike të pa autorizuar të operatorit Digitalb në rrethin e Korçës në kanalet 62, 64, 67 dhe 69.

KKRT ka marrë masa konkrete dhe po punon intensivisht për zgjidhjen e gjithë problemeve të sipërpërmendura.

4.5. PËRGATITJET PËR TRANSMETIMET NUMERIKE

4.5.1. Puna përgatitore për hartimin e projektit të strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike

Në muajin korrik 2010, KKRT përgatiti një studim për njohjen e eksperiencave evropiane në fushën e dixhitalizimit.

Materiali i përgatitur nga Grupi i punës, i ngritur në zbatim të urdhrit të Kryetarit të KKRT-së nr. 174 prot, datë 29.06. 2010, "Për krijimin e një grupi pune për nxjerrjen e eksperiencave të disa shteteve, gjatë procesit të dixhitalizimit", përmban një informacion të përgjithshëm mbi legjislacionin dhe eksperiencat e vendeve të ndryshme evropiane dhe ballkanike, lidhur me procesin e dixhitalizimit.

Materiali u përgatit bazuar në punën hulumtuese të dokumentacioneve të ndryshme, të raporteve kombëtare të vendeve të ndryshme dhe të materialeve të tjera. Për sigurimin e të dhënave janë përdorur një sërë burimesh si: pyetësi⁹ i përgatitur për çështjet e dixhitalizimit, përfshirë faqet zyrtare të internetit të autoriteteve rregullatore të vendeve të ndryshme, të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA); Komisionit Evropian; Direktoratit-Gjeneral të Shoqërisë së Informacionit dhe Medias, EUR-LEX – portali i legjislacionit të BE-së; Këshillit të Evropës; Observatorit Audiovizual Evropian, Digital, etj.

4.5.2. Puna për përfundimin e projektit të strategjisë së kalimit të plotë në transmetimet numerike

Siç është përmendur edhe në raportin për vitin 2009, më datë 02.06.2009, ka dalë Urdhri nr. 77 i Kryeministrit për “Ngritjen e Komitetit ad hoc për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale”. Ky komitet kryesohet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, dhe qëllimi i tij është të “shqyrtojë dhe vlerësojë propozimet e grupit teknik në përbërje të KKRT-së, për strategjinë më të mirë, për një kalim optimal në transmetimet dixhitale në Shqipëri”.

Në datën 27.07.2010 ka dalë Urdhri nr. 159 i Kryeministrit, i cili sjell disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 77, datë 02.06.2009. Më konkretisht, në Komitetin *Ad-Hoc* për Strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në atë dixhitale, përfshihet edhe një përfaqësues nga KKRT. Gjithashtu, bazuar në këtë Urdhër, krijohet një Sekretariat Teknik, i cili do të mbështesë punën e komitetit, “i përbërë nga jo më pak se dy ekspertë të KKRT-së dhe RTSH-së, si dhe një ekspert nga institucionet e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, AKEP-i, Zyrës Shqiptare të të Drejtave të Autorit, Televizioni Publik Shqiptar, Shoqatës së Operatorëve RTV, Zyrës për mbrojtjen e Konsumatorit, Autoriteti i Konkurrencës dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Në zbatim të Urdhrit nr. 159, datë 27.07.2010 të Kryeministrit, Ministri i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit ka përcaktuar përbërjen e Sekretariatit Teknik, i cili mbajti mbledhjen e tij të parë në datën 30 gusht 2010 duke përcaktuar programin e punës për përfundimin sa më të shpejtë të propozimit për projektstrategjinë e kalimit të plotë në transmetimet numerike. Sekretariati zhvilloi një punë intensive, që u shoqërua me debate konstruktive. Diskutimet u përqendruan në materialin bazë të paraqitur nga KKRT. Në fund

⁹ Pyetësi u hartua në bazë të listës së çështjeve që janë ngritur për zgjidhje lidhur me procesin e dixhitalizimit dhe ju dërgua rregullatorëve të vendeve të ndryshme (nëpërmjet EPRA-s) për të marrë prej tyre informacionin më të fundit dhe konkret për çështjet e interesuara.

të debatit, në datën 15 Nëntor 2010, Sekretariati Teknik miratoi projektin final që ju propozua për miratim Komitetit *ad hoc*.

Materiali i përgatitur u është dërguar, për vërejtje dhe sugjerime, edhe institucioneve partnere ndërkombëtare (ekspertëve të CSA së dhe të EBU-së (European Broadcasting Union) Bashkimi i Transmetimeve Evropianë, një organizëm i specializuar për transmetimet audiovizuale, ku RTSH është anëtar).



**V. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE,
MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN**

5.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRATIVE

Menaxhimi dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të Këshillit Kombëtar të Radio dhe Televizionit (KKRT), është theksuar në mënyrë të qartë nga raporti i fundit i Komisionit Evropian, nëntor 2010, pika 3.10 (Shoqëria e informacionit dhe media) si dhe nga rekomandimet e dala nga takimi i dytë i Nënkomitetit BE-Shqipëri mbi zhvillimin e teknologjisë, të shoqërisë së informacionit dhe të politikave sociale, zhvilluar në Bruksel (nëntor 2010).

Raporti i fundit i Komisionit Evropian thekson, ndërmjet të tjerash, se “...Kapacitet teknike dhe administrative të KKRT-së janë aktualisht të pamjaftueshme për të realizuar detyrimet e parashikuara nga “Direktiva e shërbimeve të medias audiovizuale” (Service Directive). KKRT është një institucion i pavarur, megjithatë, kërkohen masa për të garantuar pavarësinë efektive të saj, përfshirë ndryshime të legjislacionit aktual...”.

Parë në këtë kontekst, forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit ka qenë dhe mbetet një angazhim i përhershëm i institucionit, duke synuar pasjen dhe rekrutimin e punonjësve të aftë për t’u përballuar me sfidat dhe proceset, që diktohen nga zhvillimet teknologjike, me qëllim realizimin në mënyrë të suksesshme dhe të plotë të detyrimeve funksionale, të cilat rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi, si dhe nga kërkesat në rritje të plotësimit të standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në këtë fushë.

Në zbatim të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 184, datë 19.05.2008, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicionit të punës të KKRT-së”, KKRT-ja ka vazhduar organizimin e konkurseve me qëllim rekrutimin e punonjësve dhe emërimin e tyre në shërbimin civil. Gjithashtu, edhe brenda strukturës aktuale janë bërë ndryshime dhe lëvizje të stafit me qëllim përmirësimin dhe ngritjen profesionale të strukturave të veçanta të institucionit.

Edhe gjatë vitit 2010 përfaqësues të KKRT-së kanë marrë pjesë në seminare dhe trajnime, brenda dhe jashtë vendit, ku janë trajtuar çështje të ndryshme që lidhen me fushën e medias elektronike. Këto takime kanë shërbyer në marrjen e përvojave dhe praktikave më të mira në lidhje me adresimin e shumë çështjeve, që prekin fushën e medias.

Një punë e konsiderueshme është bërë nga strukturat e KKRT-së në fillim të vitit 2010 për përgatitjen e pyetësorit të dërguar nga Komisioni i BE-së, si pjesë e procedurës për aplikimin për statusin e vendit kandidat.

Gjithashtu, është punuar për përditësimin e planit kombëtar të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Puna ka konsistuar në përditësimin e pjesës narrative (përshkruese) që lidhet me fushën e politikave audiovizuale, duke përfshirë në të zhvillimet më të fundit legjislative, teknike dhe administrative, si dhe në përcaktimin e masave legjislative dhe zbatuese që duhet të realizohen në periudhat afat-shkurtër dhe afatmesme (2010-2013), në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Procesi i Stabilizim-Asociimit. Përcaktimi i këtyre masave legjislative dhe zbatuese, është shoqëruar edhe me hedhjen e tyre në sistemin “On line”, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Ministria e Integritetit, si institucion koordinues i këtij procesi.

Pavarësisht nga arritjet e deritanishme, kalimi nga transmetimet radiotelevizive analoge në ato numerike, që është përcaktuar si proces prioritar në të gjitha vendet evropiane, pjesë e BE-së ose jo, është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare dhe do të kërkonte mobilizimin e vetë përdoruesve të shërbimeve audiovizuale, të industrisë, të operatorëve të rrjetit, të ofruesve të përmbajtjes, të institucioneve dhe autoriteteve publike, të gjithë shoqërisë.

Me qëllim realizimin e plotë e në kohë të këtij procesi, konsiderohet mjaft i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të KKRT-së, në përputhje të plotë me Rekomandimin nr. R (2000) 23, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimeve”, dhe Direktivën e Shërbimeve të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, të 11 dhjetorit 2007 (AVMSD).

Në kuadër të hartimit të ligjit të ri në fushën e medias, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mënyrë permanente, ka paraqitur propozimet dhe sugjerimet e veta. Miratimi i ligjit të ri të medias audio-vizuale do të duhet të qartësojë rolin e KKRT-së, si autoritet rregullator me funksione dhe kompetenca më të gjera. (Nisur nga përafrimi i ligjit me Direktivën AVMSD, institucioni mund të marrë kompetenca mbikëqyrjeje përtej shërbimeve tradicionale radiotelevizive, edhe për shërbime të tjera audio-vizuale).

Në propozimet e paraqitura, përcaktimi i strukturës administrative nga vetë organi rregullator konsiderohet një faktor i rëndësishëm i pavarësisë së institucionit. Ligji ekzistues nr. 8410, përpara amendimit të bërë me ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, ka pasur pikërisht një rregullim të tillë, që struktura e KKRT-së përcaktohej nga vetë Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

Aftësia e institucionit rregullator për të krijuar strukturat e veta dhe fleksibiliteti i përshtatjes së tyre në mënyrë që t'u përgjigjen sa më mirë funksioneve e detyrave të institucionit, është mjaft e rëndësishme për funksionimin efikas të autoritetit rregullator.

Kompetencat dhe detyrat e KKRT-së, sipas një ligji të ri, do të kërkojnë edhe nevojën e përcaktimit të një strukture të re të institucionit, që do të mund t'u përshtatej atyre. Për këto arsye, menjëherë pas miratimit të projektligjit të ri të medias audio-vizuale, është e domosdoshme miratimi i një strukture të re të KKRT-së.

Këto ndryshime strukturore, duhet të synojnë pasjen e një strukture efikase dhe me fleksibilitet më të madh për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që hasen si pasojë e zhvillimeve teknologjike në fushën e medias, si dhe për përshpejtimin e proceseve të kalimit në sistemin numerik, duke qenë në një linjë me filozofinë rregullatore të vendeve të Bashkimit Evropian.

Siç është theksuar në mënyrë të vazhdueshme nga KKRT-ja, një problem shqetësues vazhdon të mbetet *kapaciteti i pamjaftueshëm monitorues i KKRT-së* ". Pavarësisht përmirësimeve të pjesshme, si pasojë e ndërhyrjeve rinovuese në studion aktuale të monitorimit, vlerësohet si një zgjidhje e plotë dhe përfundimtare krijimi i mundësive teknike për realizimin e monitorimeve "on line" në të gjithë territorin e vendit.

Ky shqetësim u ripërsërit nga KKRT-ja edhe në takimin e fundit të zhvilluar në Bruksel (nëntor 2010), në kuadër të takimit të dytë të Nënkomitetit BE-Shqipëri "Mbi zhvillimin e teknologjisë, shoqërisë së informacionit dhe të politikave sociale", në të cilën u kërkua përsëri mbështetja e palës komunitare në këtë drejtim.

Duke e konsideruar prioritet adresimin e këtij problemi, gjatë muajit tetor 2010, përfaqësues të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zhvilluan në Amsterdam (Holandë) një takim me përfaqësues të kompanisë holandeze "Arbor Media", e specializuar për prodhimin e pajisjeve software për monitorimin në distancë të programeve televizive.

Nga ana e tyre, përfaqësues të kompanisë, gjatë muajit dhjetor 2010, erdhën në Tiranë për të diskutuar dhe përcaktuar konkretisht nevojat e KKRT-së dhe mundësinë e realizimit të monitorimit në distancë, si dhe kostot që do të kërkonte ky investim.

Duke qenë se me buxhetin vjetor të institucionit është e pamundur të mbulohen shpenzimet që do të kërkonte realizmi i këtij investimi, paralelisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është duke punuar për të shfrytëzuar të gjitha hapësirat dhe mundësitë e bashkëpunimit me donatorë

potencialë, në marrjen e mbështetjes së duhur financiare. Kjo do të mundësonte monitorimin e plotë "on line" të programeve televizive në të gjithë territorin e Shqipërisë, ndërkohë, që, siç dihet, aktualisht ky monitorim mund të realizohet vetëm për operatorët radiotelevizivë, sinjali i të cilëve arrin në Tiranë.

Një problem tjetër, që vazhdon të mos gjejë zgjidhje, është dhe pajisja me mjedise të reja pune të KKRT-së, të cilat mund t'i garantojnë institucionit një funksionim më normal. Situata bëhet edhe më emergjente po të kihet parasysh se me vendim gjyqësor të formës së prerë, ambientet që janë aktualisht në përdorim të KKRT-së, i janë kthyer subjektit privat "Sh. A. Drini". Për zbatimin e vendimit gjyqësor është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit, çka ka krijuar një situatë të vështirë në të cilën kërkohet një ndërhyrje dhe zgjidhje e menjëhershme e këtij problemi nga institucionet më të larta të shtetit.

Mosangazhimi dhe vonesat në trajtimin dhe adresimin e kësaj çështjeje do të krijojnë vërtet një situatë të paprecedent në mosfunksionimin e institucionit për shkak të mungesës së ambienteve të punës.

Gjatë periudhës raportuese, vlen të theksohet, gjithashtu, edhe angazhimi i institucionit në mbarëvajtjen e shërbimeve të ndryshme, administrimin e bazës materiale, si dhe në plotësimin e nevojave dhe kushteve të punës të administratës.

5.2. MARRËDHËNIET ME JASHTË

Edhe për vitin raportues, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit e ka konsoliduar më tej bashkëpunimin me partnerët dhe organizmat ndërkombëtare në fushën e medias, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në takimet e zhvilluara në nivel rajonal apo evropian që lidhen me zhvillimet dhe perspektivën në fushën e medias elektronike.

Në kuadër të procesit të integritit evropian, kontaktet dhe takimet me përfaqësuesit e Komisionin Evropian, mbeten parësore në funksion të njohjes me standardet dhe praktikën më të mira si dhe të plotësimit të rekomandimeve të parashtruara nga Komisioni Evropian për fushën e medias elektronike. Këto rekomandime kanë shërbyer për të njohur më mire problematikat e fushës, standardet që kërkohen të arrihen si dhe për të ndërmarrë hapat konkretë për realizimin e tyre.

Më konkretisht, më datë 18 nëntor 2010, u zhvillua në Bruksel, takimi i dytë i Nënkomitetit BE-Shqipëri "Mbi inovacionin, shoqërinë e informacionit dhe politikën sociale", në agjendën e të cilit u përfshinë edhe çështjet që lidheshin me fushën e medias elektronike.

Këto çështje fokusoheshin kryesisht:

- në përfundimin e reformës ligjore në fushën e medias elektronike;
- në forcimin e burimeve administrative dhe teknike të KKRT-së;
- në kalimin nga transmetimi analog në atë numerik: përditësimi dhe planifikimi; dhe
- në asistencën e mundshme financiare të KE-së dhe financuesve të tjerë në fushën e medias.

Në lidhje me çështjet e tjera, ku përfshihej puna e institucionit të KKRT-së, u bë një prezantim i plotë i zhvillimeve më të fundit në fushën e medias, gjatë të cilës u dha një informacion konkret në lidhje me peizazhin aktual audiovizual: rrjetet e transmetimeve numerike, kapacitetet teknike dhe administrative të KKRT-së, si dhe, në mënyrë të veçantë, ecuria për hartimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Gjatë këtij prezantimi u theksua nevoja për mbështetje financiare me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuar si dhe arritjen e standardeve të kërkuara. U theksua gjithashtu se projektet e financuara në vite nga donatorë në këtë fushë kanë qenë të pamjaftueshme, dhe se Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit nuk ka përfituar deri më sot asnjë ndihmë financiare nga Komisioni Evropian apo dhe Këshilli i Evropës.

Përfaqësuesit e Komisionit Evropian, vlerësuan hapat dhe progresin e deritanishëm të realizuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, duke premtuar në të njëjtën kohë vlerësimin e të gjitha mundësive për të bërë të mundur dhënien e mbështetjes financiare për realizimin e objektivave që ka institucioni.

Bashkëpunimi me OSBE-në vazhdon të mbetet mjaft i rëndësishëm. Me mbështetjen e kësaj organizate, gjatë muajit shtator 2010, pjesëtarë të "Grupit teknik", të krijuar me Urdhrin nr. 77 të Kryeministrit për "Ngritjen e Komitetit *ad hoc* për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale", të ndryshuar, zhvilluan një vizitë pranë Këshillit Superior Audiovizual (CSA) të Francës, me qëllim marrjen e eksperiencës franceze për sa i përket rrugëve të kalimit në sistemin numerik.

Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e Këshillit Superior Audiovizual Francez (CSA) morën përsipër të ofrojnë ekspertizën e tyre në këtë drejtim si dhe të japin mendime dhe sugjerime mbi variantin final të strategjisë që sekretariati teknik do t'i paraqesë komitetit *ad hoc* për miratim.

Ndërkohë, do të shikohet mundësia që një specialist i Këshillit Superior Audiovizual (CSA) të asistojë në mbledhjen e komitetit *ad hoc* kur të diskutohet varianti final i strategjisë, i cili është në fazën përfundimtare të hartimit.

Gjithashtu, KKRT-ja ka thelluar më tej bashkëpunimin me autoritetet rregullatore fqinje, si janë: Autoriteti Rregullator i Kosovës, Autoriteti Rregullator i Maqedonisë, AGCOM (Itali), ARDCG (Mali i Zi) etj, në lidhje me çështje të ndryshme në fushën e medias elektronike. Përfaqësues të KKRT-së kanë marrë pjesë në shumë veprimtari dhe takimet të zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare, si dhe u janë përmbajtur detyrimeve që rrjedhin prej tyre, të tilla si:

- EPRA (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore)
- RIRM (Rrjeti i Autoriteteve Rregullatore Mesdhetare)
- KE (Këshilli i Evropës)

Më konkretisht, përfaqësues të KKRT-së kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga:

- Kompania “Digital TV”, zhvilluar në datat 25-26 mars 2010, në Bukuresht (Rumani), mbi çështjet kyçe që duhen marrë në konsideratë mbi platformën televizive, dixhitale tokësore. Qëllimi i këtij seminari ishte shkëmbimi i eksperiencave midis ekspertëve për sa i përket tranzicionit nga televizioni analog në atë dixhital, duke u fokusuar kryesisht në mundësitë e biznesit të platformave televizive dixhitale tokësore, në çështjet e marrjes së sinjaleve dhe përgatitjet për tranzicionit nga sistemi analog në atë dixhital;
- Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA), zhvilluar në datat 12-14 maj 2010, në Barcelonë (Spanjë). Çështjet kyçe që u diskutuan në këtë takim ishin implementimi i direktivës mbi shërbimet audio-vizuale, eksperiencat e para në lidhje me vendosjen e produktit, si dhe çështje praktike në lidhje me mbrojtjen e minorenëve në shërbimet me pagesë.
- Komiteti teknik i Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (RIRM), zhvilluar në datat 3-4 qershor 2010, në Izmir (Turqi), qëllimi i të cilit ishte vlerësimi i konkluzioneve të takimit të fundit plenar në Granada (Spanjë), bashkëpunimi aktual, si dhe propozimi i agjendës për takimin e ardhshëm plenar të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore;
- Ministria e Telekomunikacionit dhe Shoqërisë së Informacionit të Republikës së Serbisë, zhvilluar në datat 15-16 qershor 2010, në Beograd (Serbi), takimi i Ministerialit të Evropës Jug-Lindore “Mbi dividendin dixhital”, qëllimi i të cili kishte të bënte me dividendin dixhital si dhe avantazhet ekonomike dhe sociale që ai mund të sjellë në kuadër të dixhitalizimit të medias;
- Rrjeti Mesdhetar i Autoriteteve Rregullatore (RIRM), zhvilluar në datat 24-25 qershor 2010, në Malaga (Spanjë), me temë “Ndërgjegjësimi mediatik dhe mbrojtja e fëmijëve”, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet vendeve në çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve në fushën e medias elektronike;

- Këshilli i Evropës, zhvilluar në datat 1-2 korrik 2010, në Strasburg (Francë) në kuadër të Takimit të 45-të i Komitetit të Përhershëm mbi Televizionin Ndërkufitar. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi ndërmjet vendeve anëtare në lidhje me procesin e rishikimit të kësaj Konvente;
- Rrjeti Mesdhetar i Autoritete Rregullatore (RIRM), zhvilluar në datat 30 shtator - 1 tetor 2010, në Stamboll, takim i cili iu kushtua mbrojtjes së të miturve si dhe përfaqësimit të grave në media;
- Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA), zhvilluar në datat 8-9 tetor 2010 në Beograd, ku u diskutuan çështje në lidhje me rregullat e reklamës, modelet e licensimit dhe rregullimit të dixhitalizimit, si dhe vendosjen e produktit në programet televizive;
- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), zhvilluar në datat 14-15 tetor 2010, në Sarajevë, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit rajonal për procesin në vazhdim të kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale.

Në sinkron me kërkesat e legjislacionit, rekomandimet e BE-së dhe proceset integruese që po kalon vendi ynë, KKRT, në muajt e parë të vitit 2010, u angazhua maksimalisht në hartimin e përgjigjeve të pyetjeve të *Pyetësorit* të Bashkimit Evropian për fushën e medias. Përgjigjet e pyetjeve u mbështetën në përvojën e punës të KKRT-se, si dhe në sintetizimin e përgjithësimin e arritjeve dhe vërejtjeve të veprimtarisë së operatorëve radiotelevizivë. Faktor i rëndësishëm në këtë proces ishte bashkëpunimi i frytshëm dhe konsultimi me organizma të afërta me median, si dhe me specialistët më të mirë të kësaj fushe. Procesi u trajtua në tri anët kryesore: në pasqyrimin e situatës legjislative për median në Shqipëri, në nevojën e vazhdueshme për përafrimin e ligjeve tona me legjislacionin e vendeve të BE-së dhe në zbatimin e respektimin e kërkesave të këtij legjislacioni nga operatorët radiotelevizivë.

5.3. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE GRUPET E INTERESIT

Transparenca e vazhdueshme e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit si dhe zhvillimi i një komunikimi të pandërprerë me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e medias, ka qenë dhe mbetet një objektiv primar i këtij institucioni. Gjatë viti 2010 janë publikuar, përmes faqes së internetit, të gjitha vendimet e KKRT-së, veprimtaritë kryesore të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, si dhe janë mbajtur disa konferenca për shtyp për çështje të veçanta që lidheshin, kryesisht, me probleme që i interesonin një opinionioni më të gjerë publik.

Një nga veprimtaritë më kryesore, për të cilën KKRT-ja është investuar më tepër për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik ka qenë Konferenca Kombëtare "Televizioni dixhital - sa afër, sa larg", organizuar më 27 prill 2010 nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në të cilën morën pjesë përfaqësues të medias televizive,

kombëtare dhe vendore, institucionet shtetërore që përfshihen në këtë ndërmarrje të rëndësishme të kalimit tërësor të Shqipërisë nga transmetimet analoge në transmetime numerike, si dhe ekspertë të Prezencës së OSBE në Shqipëri.

Ballafaqimi me grupet e interesit evidentoi më mirë edhe përvojën e fituar deri tani nga iniciativat private, si dhe vështirësitë e pritshme të kapërcimit final në transmetimet numerike në respekt të afateve dhe të parametrave të përcaktuara nga BE-ja dhe institucionet e saj. Gjithashtu, ky ballafaqim gjithëpërfshirës doli në përfundime më realiste për afatet dhe hapat që duhen ndërmarrë në vijim. Arritjes së këtyre objektivave në vazhdimësi u ka shërbyer, krahas të tjerave, edhe një dritare në faqen e internetit, titulluar KONFERENCA KOMBËTARE “Televizioni dixhital - sa afër, sa larg”.

Një nga instrumentet e komunikimit të vazhdueshëm me operatorët por edhe me publikun ka qenë dhe mbetet faqja elektronike e KKRT-së, e cila i është nënshtruar përmirësimeve të vazhdueshme, duke synuar dhënien e një informacioni sa më të plotë dhe të detajuar për të gjithë veprimtarinë e kryer nga KKRT-ja si dhe marrjen e çdo informacioni, rekomandimi ose sugjerimi të dobishëm nga publiku i gjerë si dhe nga operatorët radiotelevizivë për përmirësimin e mëtejshëm të kësaj faqeje. Nëpërmjet këtij instrumenti komunikimi, KKRT-ja realizon në rritje funksionin e vet kryesor: ndërmjetësimin e publikut me operatorët.

Një nga pikësynimet më ambicioze të sektorit të marrëdhënieve me publikun është zgjerimi i komunikimit me publikun, konsumator i produktit radioteleviziv, lidhur me respektimin e normave etike e morale nga subjektet e licencuara prej KKRT-së. Publiku ynë duhet të sensibilizohet hap pas hapi me detyrimet që kanë subjektet mediatike ndaj tij, veçanërisht në respektimin e etikës, kur është fjala për pasqyrimin e dhunës, të pornografisë dhe të cenimit të dinjitetit të njeriut. Marrëdhëniet me qytetarët, në funksion të ruajtjes së etikës në transmetimet audio-vizuale, vazhdojnë të mbeten një nga objektivat e punës të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. KKRT vazhdon të ketë si prioritet, në lidhje me këtë aspekt, etikën në programet televizive, zbatimin e normës së gjuhës shqipe, të ruajtjes së dinjitetit dhe privatësisë së njeriut, të mbrojtjes së të miturve nga dhuna ose nga abuzimi etj.



VI. BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË

Për vitin 2010, burimi i vetëm i financimit të institucionit janë të ardhurat e veta, të përdorura sipas limiteve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 24.03.2010 “Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2010”. KKRT, ka punuar në drejtim të njohjes së situatës ekonomike e financiare të aktivitetit radioteleviziv të operatorëve dhe funksionimit racional të administratës së KKRT.

6.1. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN 2010

Përlllogaritja e detyrimeve financiare të pagesave vjetore për licencë dhe të taksave për shërbimet RTV për operatorët aktivë të licencuar, mbi bazën e treguesve analitikë të numrit të popullsisë së zonave të licencimit, numrit të transmetuesve të operatorëve dhe fuqisë së rrezatimit të tyre, është burimi bazë i të dhënave për hartimin e buxhetit të Institucionit në treguesin kryesor financiar – Të Ardhura.

Me daljen e Vendimeve të KKRT-së për organizimin e konkurrimeve të kandidaturave për licencimin dhe rilicencimin e operatorëve privatë radio e televizive, Drejtoria Ekonomike ka hartuar dhe përgatitur dokumentacionin ekonomik e financiar, pjesë e dokumentacionit të konkurrimit.

Treguesit financiarë për vitin 2010, janë miratuar sipas strukturës, si më poshtë:

Në milion lekë

Të ardhura të krijuara në vitin 2010	217.7
Te ardhura për t’u trashëguar vitin e ardhshëm	115.5
Shpenzime korente	80.8
Shpenzime për investime	21.4

Realizimi i treguesve financiarë – TË ARDHURAT

Struktura e zërit “Të Ardhura”, e parashikuar dhe e realizuar për vitin 2010, paraqitet:

Në mln lekë

Nr	Zërat e të ardhurave	Plani vjetor	Realizimi vjetor	%
1	Të ardhura nga pagesat vjetore për licencë	136.6	38.37	28
	Nga këto:			
	a) Të ardhura të faturuara	61.6	38.35	
	Pagesa për licencë nga operatorët analogë tokësorë e kabllorë	50.4	34.62	
	Pagesa për licencë nga operatorët e platformës numerike satelitore	11.2	3.75	.5
	b) Të ardhura të pafaturuara	75.0		
	Pagesa për licencë nga operatorët e rrjeteve numerike tokësore kombëtare	45.0	0	
	Pagesa për licencë nga operatorët e programeve të platformës numerike satelitore	30.0	0	
2	Të ardhura nga pagesa për marrjen e licencës dhe rinovimin e licencës nga:	76.7	1.2	
	a) Operatorët analogë tokësorë e kabllorë	1.7	1.2	71
	b) Operatorët e rrjeteve numerike kombëtare tokësore	45	0	
	c) Operatorët e programeve të platformës numerike satelitore	30	0	
3	Të ardhura nga përpunimi i dokumenteve të licencës	1.8	1.7	95
4	Të ardhura nga përfitimet si agjent tatimor	1.2	1.46	123
5	Të ardhura nga interesa bankare për depozitat në bankë	1.3	1.82	141
6	Të ardhura të tjera	0.1	0.64	640
7	Të ardhura të viteve të kaluara		23.25	
	Gjithsej Të ardhura	217.7	68.44	

Realizimi i zërit “Të ardhura nga pagesa vjetore për licencë dhe pagesa për marrjen e licencës”

A. Të ardhurat e faturuara, nga pagesat për licencë nga operatorët analogë tokësorë e kabllorë, si dhe nga pagesat për licencë për platformën numerike satelitore për vitin 2010 të planifikuara në masën prej rreth 62 milion lekë, janë realizuar në masën prej 38.35 milion lekë ose 63 %. Kjo përqindje është funksion i afateve të vitit të

licencimit të operatoreve dhe si rrjedhojë e afateve të pagesës për vit licencimi. Nga 220 operatorë të cilët operojnë në fushën e mediave vizive, rreth 60% e tyre e kanë afatin përfundimtar të shlyerjes së pagesave vjetore të vitit 2010 në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011.

Për këtë arsye, KKRT, për zhvillimin normal të aktivitetit ka përdorur fondet e akumuluar si dhe fondet e faturuara në vitet e kaluara por që depozitohen në llogarinë e KKRT në vitin kalendarik aktual.

B. Në zbatim të Vendimit të KKRT nr. 726, datë 8.09.2008 “Për organizimin e konkurimit të kandidaturave për operatorë privatë të rrjeteve numerike tokësore kombëtare”, për vitin 2010 u parashikua krijimi i të ardhurave nga **pagesat vjetore për licencë dhe pagesat për marrjen e licencës për rrjetet numerike tokësore kombëtare.**

Me gjithë përpjekjet e KKRT-së, edhe këtë vit nuk u arrit të realizohej licencimi i rrjeteve ekzistuese numerike dhe programeve të mbështetura mbi to. Pengesat kryesore në këtë drejtim kanë qenë mungesa e strategjisë së kalimit në transmetimet numerike dhe mangësitë e ligjit ekzistues “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë kuadër, KKRT është e detyruar të presë miratimin e strategjisë dhe të ligjit, efektet financiare prej 90 milion lekë (45 milion pagesë vjetore për licencë dhe 45 milion pagesë për marrjen e licencës për tre rrjetet numerike tokësore), pasqyrohen në mosrealizimin e të ardhurave të vitit 2010.


Gjithashtu për të njëtat arsye të përmendura më lart, nuk janë licencuar edhe operatorët e programeve të platformës numerike satelitore, duke sjellë diferencë negative në të ardhurat e planifikuara prej 60 milion lekë (30 milion lekë pagesë vjetore për licencë, 30 milion lekë pagesë për marrjen e licencës).

Nisur nga afatet ligjore të shlyerjes së detyrimeve në bazë të vitit të licencimit, gjatë vitit 2010, janë arkëtuar edhe detyrime të vitit 2009, në masën prej 23.24 milion lekë.


Të ardhurat për marrjen dhe rinovimin e licencës janë realizuar në shumën rreth 1.2 milion lekë ose 71% , nga përpunimi i dokumenteve për marrjen dhe rinovimin e licencave rreth 1.7 milion lekë ose 95% , nga agjenti tatimor në shumën prej rreth 1.46 milion lekë ose 123%, nga interesa bankare 1.82 milion lekë ose 140% dhe të tjera të ardhura si pagesat për marrje dokumentesh, shërbime të ndryshme për tërheqje dokumentesh në shumën 0.64 milion lekë.

Për sa më lart, gjatë vitit 2010, në llogarinë e KKRT janë arkëtuar të ardhura në shumën prej rreth **68.4 milion lekë.**

Në fushën e mediave elektronike për vitin 2010, kanë qenë aktivë 220 operatorë, të klasifikuar sipas llojit të aktivitetit si më poshtë:



Të ardhurat e realizuara nga shlyerja e detyrimeve financiare të pagesave për licencë pasqyrohen në grafikun vijues:



Krahasuar me nivelet e të ardhurave të planifikuara, realizimi i të ardhurave nga pagesat për licencë arrin në rreth 56.1 %. I detajuar, realizimi nga operatorët radio është 80.75 %, nga operatorët TV me frekuencë 56.2 %, nga operatorët TV kabllorë me 59.9 % dhe nga operatorët e platformës numerike satelitore 33.3 %.

Pagesat e mbartura nga viti paraardhës krijohen pasi pagesa vjetore për licencë e cila llogaritet për vit licencimi, mund të faturohet në vitin paraardhës por paguhet në vitin pasardhës. Një shkak tjetër është neglizhenca e operatorëve për shlyerjen në afat të detyrimeve. Për penalizimin e këtyre rasteve operatorët merren në konsideratë nga KKRT, duke marrë masat përkatëse, deri në shpalljen e pavlefshmërisë së licencës (Aneksi V).

Të ardhurat nga agjenti tatimor – Taksat për shërbimet radiotelevizive

Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ngarkon KKRT-në në rolin e agjentit tatimor, për transferimin në buxhetin e shtetit të taksës vjetore për shërbimet radiotelevizive të subjekteve. Për këtë shërbim, KKRT përfiton 5 për qind të vlerës së arkëtuar dhe të transferuar në buxhetin e shtetit.

Për vitin 2010, janë transferuar në buxhetin e shtetit rreth 14.35 milion lekë, nga të cilat 9.65 milion lekë taksa për shërbimet RTV detyrime të vitit 2010 dhe 4.7 milion lekë detyrime të viteve të kaluara. Nga KKRT, si agjent tatimor janë përfituar rreth 0.72 milion lekë.

Të ardhurat nga interesat bankare për fondet e depozituara në bankë për periudhën janar – dhjetor 2010 janë rreth 1.82 milion lekë.

Për sa analizuam më sipër vlen të theksojmë se KKRT, duke ndjekur realizimin e të ardhurave në lekë, ka kryer shpenzime sipas zërave të miratuara, duke likuiduar ato prioritare, emergjente dhe të detyrueshme, sipas analizës së mëposhtme:

Realizimi i treguesve financiarë - SHPENZIMET

Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr. 195 datë 24.3.2010, “Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2010”, miratoi fondin limit të shpenzimeve për këtë vit të detajuar si më poshtë:

Shpenzime korente	80.8
Shpenzime për investime	21.4
Gjithsej	102.2

Për periudhën janar – dhjetor 2010, realizimi i shpenzimeve sipas strukturës paraqitet:

Mil/lekë

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve	Plan	Realizim	%
1.	Shpenzime korente (operative)	80.8	69.08	85
	a) Paga e kontribute	53.5	50.16	94
	b) Shpenzime materiale e të tjera	27.3	18.92	69
2.	Shpenzime për investime	21.4	3.65	17
	a) Rikonstruksioni i taracës	5.2	1.56	30
	b) Instalimi i sistemit të sigurisë për hyrje në institucion	0.6	0.396	66
	c) Blerje pajisje zyre	2	1.13	57
	d) Blerje pajisje operacionale specifike	3.4	0.57	17
	e) Sistemi i monitorimit në distancë	3.6	0	


f)Shpenzime për transferimin e frekuencave analoge në digitale	10.1	0	
--	------	---	--

Shpenzime operative

Shpenzimet operative janë realizuar në masën prej 69.08 milion lekë ose 85% e shumës së planifikuar. Realizimi në këtë masë ka ardhur për arsye se: Realizimi i zërit “Paga e kontribute të tjera” në masën prej 94% ka ardhur si rrjedhojë e lëvizjes të disa punonjësve gjatë vitit 2010 dhe plotësimit të organikës pas pak muajve.

Gjatë vitit 2010, shpenzimet për honorare janë realizuar në masën 0.95 milionë lekë ose 29%, për arsye se Këshilli i KKRT nuk u mbledh për një periudhë prej pesë muajsh, mbasi nuk bëhej kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje si dhe për mosfunksionimin e Këshillit të Etikës gjatë këtij viti.

Gjithashtu, shtyrja e tenderit për ruajtjen e godinës solli mos realizimin e shpenzimeve për këtë zë.



Shpenzimet për investime

